

K. MARKS
F. ENGELS

VEPRA TË ZGJEDHURA

NË DY VËLLIME

VËLLIMI

I

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

TIRANË, 1975

K. MARKS E F. ENGELS

MANIFESTI I PARTISË KOMUNISTE¹

PARATHËNIE E BOTIMIT GJERMANISHT TË VITIT 1872

«Lidhja e Komunistëve»², organizata ndërkombëtare e punëtorëve, e cila në kushtet e atëhershme, natyrisht, mund të ishte vetëm një organizatë e fshehtë, në kongresin që u mbajt në nëntor të vitit 1847 në Londër, i ngarkoi të nënshkruarit të pregatisnin për botim një program të hollësishëm teorik e praktik të partisë. Kështu lindi ky «Manifest», dorëshkrimi i të cilit u dërgua në Londër për t'u shtypur pak javë përpara revolucionit të shkurtit*. I botuar për herë të parë gjermanisht, «Manifesti» pati në këtë gjuhë të paktën dymbëdhjetë botime të ndryshme në Gjermani, në Angli dhe në Amerikë. Anglisht ai doli për herë të parë më 1850 në Londër në «Red Republican»³, përkthyer nga mis Elen Makfarlein, pastaj më 1871, të paktën në tri përkthime të ndryshme, — në Amerikë. Frëngjisht ai doli për herë të parë në Paris, pak kohë përpara kryengritjes së qershorit 1848⁴ dhe tani vonë — në «Le Socialiste»⁵ të Nju-Jorkut. Është duke u përgatitur një përkthim i ri. Polonisht ai doli në Londër pak kohë pas botimit të parë gjermanisht. Rusisht ai doli në Gjenevë në dhjetëvjetëshin 1860-1870. Danisht ai u përkthye gjithashtu pak kohë pas daljes së tij në dritë.

Megjithëse këta njëzet e pesë vjetët e fundit gjendja ka ndryshuar shumë, parimet themelore të përgjithshme që zhvillohen në këtë «Manifest» mbeten, në tërësi, fare të drejta edhe sot e kësaj dite. Në disa vende do të ishte nevoja të bëhej ndonjë korrigjim. Zbatimi praktik i këtyre parimeve the-

* Është fjala për revolucionin e shkurtit 1848 në Francë. *Red.*

melore, sikurse e thotë vetë «Manifesti», do të varet kudo dhe kurdoherë nga kushtet historike ekzistuese, dhe prandaj masat revolucionare, të propozuara në fund të kapitullit II, nuk duhen parë si të mjaftueshme në vetëvete. Sot kjo pjesë, në shumë drejtime, do të tingëllonte ndryshe. Për shkak të zhvillimit të fuqishëm që mori industria e madhe këta njëzet e pesë vjetët e fundit dhe të zhvillimit të njëkohshëm të organizimit të partisë të klasës punëtore, për shkak të eksperiencës praktike që u fitua në fillim nga revolucioni i shkurtit, pastaj, në një shkallë edhe më të madhe, nga Komuna e Parisit⁶, kur për herë të parë pushteti politik për dy muaj rresht u ndodh në duart e proletariatit, ky program tani vende-vende është vjetruar. Komuna provoi sidomos se «klasa punëtore nuk mund ta shtjerrë në dorë të gatshme maqinën shtetërore dhe ta vërë atë në lëvizje për qëllimet e veta» (shih «Lufta civile në Francë. Thirrja e Këshillit të Përgjithshëm të Shoqatës Ndërkombëtare të Punëtorëve», botimi gjermanisht, f. 19, ku ky mendim është zhvilluar në mënyrë më të plotë)*. Pastaj kuptohet vetëvetiu se kritika që i bëhet letërsisë socialiste nuk është e plotë për kohën e sotme, meqë ajo arrin vetëm deri në vitin 1847; kuptohet gjithashtu vetëvetiu se ato që thuhet për qëndrimin e komunistëve kundrejt partive të ndryshme opozitare (kapitulli IV), ndonëse në vija të përgjithshme janë të drejta edhe për kohën e sotme, përsa i përket zbatimit të tyre praktik janë vjetruar, sepse gjendja politike ka ndryshuar fare dhe shumica e partive që përmenden atje, është fshirë nga faqja e dheut prej zhvillimit historik.

Por «Manifesti» është një dokument historik, të cilin ne s'kemi më të drejtë ta ndryshojmë. Ndoshta në një botim të ardhshëm mund t'i shtohet një hyrje, e cila të përfshijë periudhën prej vitit 1847 deri në ditët tona; ky botim i «Manifestit» që aq i papritur për ne, saqë nuk patëm kohë për një punë të tillë.

Londër, 24 qershor 1872

Karl Marks. Fridrih Engels

* Shih këtë vëllim, f. 541. Red. Përkth.

PARATHËNIE E BOTIMIT RUSISHT TË VITIT 1882

Botimi i parë rusisht i «Manifestit të Partisë Komuniste», përkthyer nga Bakunini, doli në fillim të dhjetëvjetëshit 1860-1870*; u botua në shtypshkronjën «Kollokoll». Në atë kohë botimi rusisht i «Manifestit» mund të dukej në Perëndim vetëm si një kuriozitet letrar. Sot është ndryshe.

Se sa pak ishte përhapur asokohe (dhjetor 1847) lëvizja e proletariatit, e tregon më së miri kapitulli i fundit i «Manifestit»: «Qëndrimi i komunistëve kundrejt partive të ndryshme opozitare në vendet e ndryshme». Aty nuk zihen në gojë pikërisht Rusia dhe Shtetet e Bashkuara. Kjo ishte koha kur Rusia përbënte rezervën e fundit të madhe të gjithë reaksionit evropian dhe kur emigrimi në Shtetet e Bashkuara përpinte forcat e tepërta të proletariatit evropian. Që të dyja këto vende e furnizonin Evropën me lëndë të para dhe shërbenin në të njëjtën kohë si treg për shitjen e prodhimeve të saj industriale. Kështu që të dyja këto vende asokohe ishin në një mënyrë ose në një tjetër mburoja të regjimit që ekzistonte në Evropë.

Sa ka ndryshuar sot gjithë kjo! Pikërisht imigrimi evropian ndihmoi që në Amerikën Veriore të zhvillohej shumë prodhimi bujqësor, i cili me konkurrencën e vet po e trondit nga themelet pronën e madhe dhe të vogël të tokës në Evropë. Ai, përveç kësaj, u dha mundësi Shteteve të Bashkuara t'i përvishen shfrytëzimit të burimeve të tyre të pasura për zhvillimin industrial në përpjesëtime të tilla dhe me një energji të tillë, që brenda një kohe të shkurtër duhet t'i japin fund monopolit industrial të Evropës Perëndimore dhe sidomos të Anglisë. Vetë këto dy rrethana ndikojnë, nga pikëpamja revolucionare, edhe mbi Amerikën. Prona e tokës e vogël dhe e mesme e fermerëve, baza e gjithë sistemit të saj politik, po mposhtet dalëngadalë nga konkurrenca e fermave të mëdha; në të njëjtën kohë në qarqet industriale po zhvillohet për herë të parë një proletariati i madh në numër dhe po bëhet një koncentrim përrallor kapitalesh.

Të kalojmë te Rusia! Në periudhën e revolucionit të vjetëve 1848-1849 jo vetëm monarkët evropianë, por edhe borgjezët evropianë ndërhyrjen ruse e shikonin si të vetmin shpëtim

* Botimi i lartpërmendur doli më 1869. Red.

nga proletariati, i cili porsa kishte filluar të zgjohej. Ata e shpallën carin udhëheqës të reaksionit evropian. Tani ai është mbyllur në Gatçinë, si rob i revolucionit, dhe Rusia sot është bërë reparti pararojë i lëvizjes revolucionare në Evropë.

Detyra e «Manifestit komunist» ishte të shpallte zhdukjen e afërt dhe të pashmangshme të pronës së sotme borgjeze. Por në Rusi krahas me zhvillimin e ethshëm të kapitalizmit, dhe krahas me pronën borgjeze të tokës, që vetëm tani po formohet, ne vëmë re se më tepër se gjysma e tokës është pronë e përbashkët e fshatarëve. Tani del pyetja: a mundet vallë obshçina* ruse — kjo formë tepër e shkatërruar e zotërimit të përbashkët primitiv të tokës — të kalojë menjëherë në formën më të lartë, në formën komuniste të zotërimit të tokës? Apo, përkundrazi, ajo duhet të kalojë në fillim po atë proces dekompozimi që ka karakterizuar zhvillimin historik të Perëndimit?

E vetmja përgjegje, që mund t'i jepet sot kësaj pyetjeje, është kjo: në qoftë se revolucioni rus do të shërbejë si një sinjal për revolucionin proletar në Perëndim, në mënyrë që të plotësojnë njëri-tjetrin, atëherë prona e sotme e përbashkët e tokës në Rusi mund të jetë pikënisja e zhvillimit komunist.

Londër, 21 janar 1882

Karl Marks, Fridrih Engels

PARATHËNIE E BOTIMIT GJERMANISHT TË VITIT 1883

Mjerisht, parathënien e këtij botimi duhet ta nënshkruaj vetëm unë. Marks — njeriu të cilit i detyrohet më tepër se kujtdo tjetër klasa punëtore e Evropës dhe e Amerikës, — pushon në varrezat Hajgejt dhe varrin e tij tani e ka mbuluar bari i parë. Pas vdekjes së tij më pak se kurrë mund të bëhet fjalë për një ripunim ose plotësim të «Manifestit». Bile unë e quaj të nevojshme të them edhe një herë këtu me qartësi të plotë sa vijon:

* Në origjinal fjala rusisht obshçina [komunë] është shkruar me shkronja latine. Red. Përkth.

Mendimi kryesor, që përshkon gjithë «Manifestin», domethënë mendimi se prodhimi ekonomik dhe struktura e shoqërisë, që rrjedh patjetër prej tij, formojnë në çdo epokë historike bazën e historisë politike dhe intelektuale të kësaj epoke; se në përshtatje me këtë (që nga koha e shkatërrimit të pronës së përbashkët primitive të tokës) e gjithë historia ka qenë histori e luftës së klasave, e luftës midis klasave të shfrytëzuara dhe shfrytëzuese, midis klasave të nënshtruara dhe sunduese në etapat e ndryshme të zhvillimit shoqëror, dhe se tani kjo luftë ka arritur një shkallë, në të cilën klasa e shfrytëzuar dhe e shtypur (proletariati) nuk mund të çlirohet nga klasa që e shfrytëzon dhe e shtyp (borgjezia), pa çliruar njëkohësisht dhe përgjithmonë gjithë shoqërinë nga shfrytëzimi, nga shtypja dhe nga lufta e klasave, — ky mendim kryesor i përket kryekëput Marksit dhe vetëm atij*.

Këtë unë e kam thënë herë pas here, por pikërisht sot është nevoja ta shkruaj në parathënien e vetë «Manifestit».

Londër, 28 qershor 1883

F. Engels

NGA PARATHËNIA E BOTIMIT GJERMANISHT TË VITIT 1890

«Manifesti» pati fatin e vet. Kur doli për herë të parë, u prit me entuziazëm (siç e provojnë përkthimet e përmendura në parathënien e parë) nga pararoja e socializmit shkencor, e cila atëherë ishte e paktë në numër, po më vonë ai u shty në

* «Këtij mendimi, — kam shkruar unë në parathënien e përkthimit anglisht, — i cili, sipas meje, duhet të ketë për historinë po atë rëndësi që pati për biologjinë teoria e Darvinit, ne të dy i qemë afruar gradualisht qysh disa vjet përpara 1845-ës. Se sa kam mundur unë të përparoj vetë në këtë drejtim, më mirë se çdo gjë tjetër mund ta tregojë vepra ime «Gjendja e klasës punëtore në Angli». Dhe kur unë, në pranverë të vitit 1845, u takova përsëri me Marksën në Bryksel, ai e kishte përpunuar këtë mendim dhe, ma parashtrroi pothuajse aq qartë, sa e kam paraqitur unë këtu». (Shënim i Engelsit për botimin gjermanisht të vitit 1890.)

e lëshuam këtë kushtrim në botë në prakun e revolucionit të Parisit, i pari revolucion në të cilin proletariati doli me kërkesat e veta*. Por më 28 shtator 1864 proletarët e shumicës së vendeve të Evropës Perëndimore u bashkuan në Shoqatën Ndërkombëtare të Punëtorëve, që la një kujtim të lavdishëm. Është e vërtetë se Internacionalja vetë nuk jetoi më shumë se nëntë vjet. Por dita e sotme është prova më e mirë që tregon se bashkimi i përjetshëm i proletarëve të të gjitha vendeve, i themeluar prej Internacionales, vazhdon të jetojë, bile është bërë më i fortë se kurrë. Sepse sot, kur unë po shkruaj këto radhë, proletariati evropian dhe amerikan po bën parakalimin e forcave të veta luftarake, të cilat për të parën herë janë mobilizuar si një ushtri e vetme, nën një flamur të vetëm, për një qëllim imediat të vetëm — për vendosjen me ligj të ditës normale 8-orëshe të punës, të shpallur qysh nga Kongresi i Internacionales në Gjenevë më 1866, dhe më vonë — për të dytën herë — nga Kongresi Punëtor i Parisit më 1889. Dhe dita e sotme do t'u tregojë kapitalistëve dhe çifligarëve të të gjitha vendeve se proletarët e të gjitha vendeve janë bashkuar tani me të vërtetë.

Ah sikur ta kisha tani Marksini pranë, që ta shihte këtë me sytë e vet!

Londër, 1 maj 1890.

F. Engels

* Është fjala për kryengritjen e qershorit 1848. Red. Përkth.

MANIFESTI I PARTISË KOMUNISTE

Një fantazmë sillet nëpër Evropë — fantazma e komunizmit. Të gjitha forcat e Evropës plakë, papa dhe cari, Meternihu dhe Gizoi, radikalët francezë dhe policët gjermanë janë bashkuar për t'i bërë luftën e shenjtë kësaj fantazme.

Cila është ajo parti opozitare, që nuk është akuzuar si komuniste nga kundërshtarët e saj në fuqi? Cila është ajo parti opozitare, që nuk i ka akuzuar gjithashtu si komunistë, për t'i poshtëruar, si përfaqësuesit më të përparuar të opozitës, ashtu edhe kundërshtarët e saj reaksionarë?

Dy konkluzione dalin nga ky fakt.

Komunizmin tashmë e njohin si një forcë të gjitha fuqitë evropiane.

Ka ardhur koha që komunistët të shtrojnë haptazi përpara gjithë botës pikëpamjet e veta, qëllimet e veta, aspiratat e veta dhe që përralla të për fantazmën e komunizmit t'u vënë përballë një manifest të vetë partisë.

Për këtë qëllim u mbledhën në Londër komunistët e kombësive më të ndryshme dhe hartuan këtë «Manifest», i cili po botohet anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, në gjuhën flamine dhe daneze.

e lëshuam këtë kushtrim në botë në prakun e revolucionit të Parisit, i pari revolucion në të cilin proletariati doli me kërkesat e veta*. Por më 28 shtator 1864 proletarët e shumicës së vendeve të Evropës Perëndimore u bashkuan në Shoqatën Ndërkombëtare të Punëtorëve, që la një kujtim të lavdishëm. Është e vërtetë se Internacionalja vetë nuk jetoi më shumë se nëntë vjet. Por dita e sotme është prova më e mirë që tregon se bashkimi i përjetshëm i proletarëve të të gjitha vendeve, i themeluar prej Internacionales, vazhdon të jetojë, bile është bërë më i fortë se kurrë. Sepse sot, kur unë po shkruaj këto radhë, proletariati evropian dhe amerikan po bën parakalimin e forcave të veta luftarake, të cilat për të parën herë janë mobilizuar si një ushtri e vetme, nën një flamur të vetëm, për një qëllim imediat të vetëm — për vendosjen me ligj të ditës normale 8-orëshe të punës, të shpallur qysh nga Kongresi i Internacionales në Gjenevë më 1866, dhe më vonë — për të dytën herë — nga Kongresi Punëtor i Parisit më 1889. Dhe dita e sotme do t'u tregojë kapitalistëve dhe çifligarëve të të gjitha vendeve se proletarët e të gjitha vendeve janë bashkuar tani me të vërtetë.

Ah sikur ta kisha tani Marks sin pranë, që ta shihte këtë me sytë e vet!

Londër, 1 maj 1890.

F. Engels

* Është fjala për kryengritjen e qershorit 1848. Red. Përkth.

MANIFESTI I PARTISË KOMUNISTE

Një fantazmë sillet nëpër Evropë — fantazma e komunizmit. Të gjitha forcat e Evropës plakë, papa dhe cari, Meternihu dhe Gizoi, radikalët francezë dhe policët gjermanë janë bashkuar për t'i bërë luftën e shenjtë kësaj fantazme.

Cila është ajo parti opozitare, që nuk është akuzuar si komuniste nga kundërshtarët e saj në fuqi? Cila është ajo parti opozitare, që nuk i ka akuzuar gjithashtu si komunistë, për t'i poshtëruar, si përfaqësuesit më të përparuar të opozitës, ashtu edhe kundërshtarët e saj reaksionarë?

Dy konkluzione dalin nga ky fakt.

Komunizmin tashmë e njohin si një forcë të gjitha fuqitë evropiane.

Ka ardhur koha që komunistët të shtrojnë haptazi përpara gjithë botës pikëpamjet e veta, qëllimet e veta, aspiratat e veta dhe që përrallave për fantazmën e komunizmit t'u vënë përballë një manifest të vetë partisë.

Për këtë qëllim u mbledhën në Londër komunistët e kombësive më të ndryshme dhe hartuan këtë «Manifest», i cili po botohet anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, në gjuhën flaminge dhe daneze.

I

BORGJEZË DHE PROLETARË*

Historia e të gjitha shoqërive, që kanë ekzistuar deri më sot**, është historia e luftës së klasave.

I liri dhe skllavi, patrici dhe plebeu, çifligari dhe bujkrobi, mjeshtri*** dhe shegerti, shkurt — shtypësi dhe i shtypuri kanë qenë në antagonizëm të përjetshëm me njëri-tjetrin, kanë bërë një luftë të parreshtur, herë të mbuluar, herë të hapët,

*Me fjalën borgjezi duhet kuptuar klasa e kapitalistëve të sotëm, e pronarëve të mjeteve të prodhimit shoqëror, që përdorin punën me mëditje. Me fjalën proletariati duhet kuptuar klasa e punëtorëve të sotëm me mëditje, të cilët, duke qenë të zhveshur nga mjetet e tyre të prodhimit, janë të shtërnguar të shesin për të jetuar fuqinë e tyre punëtoze. (*Shënim i Engelsit për botimin anglisht të vitit 1888.*)

** Domethënë gjithë historia, që ne kemi në dokumenta të shkruar. Më 1847 parahistoria e shoqërisë, organizimi shoqëror, që vjen para gjithë historisë së shkruar, ishte ende pothuajse krejt e panjohur. Që prej asaj kohe e deri më sot Haktshauzeni zbuloi pronën e përbashkët të tokës në Rusi, Maureri provoi se kjo ka qenë baza shoqërore, që ka shërbyer si pikënisje e zhvillimit historik të të gjitha tribuve gjermane, dhe pak nga pak u gjet se komuna fshatare me zotërimin e përbashkët të tokës është ose ka qenë kudo në të kaluarën forma primitive e shoqërisë, nga India deri në Irlandë. Mbi organizimin e brendshëm të kësaj shoqërie komuniste primitive në formën e saj tipike hodhi dritë Morgani, i cili e kurorëzoi këtë gjë me zbulimin e thelbit të vërtetë të fisit dhe të pozitës që ky zinte në tribu. Me dekompozimin e kësaj komuneje primitive fillon diferencimi i shoqërisë në klasa të veçanta dhe, në fund të fundit, antagonizmi. Unë jam munduar ta analizoj këtë proces dekompozimi në vepërën: «Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit», bot. i 2-të, Shtutgart, 1886. (*Shënim i Engelsit për botimin anglisht të vitit 1888.*)

*** Mjeshtri është anëtar i esnafit me të drejta të plota, mjeshtër brenda esnafit, dhe jo përgjegjës i esnafit. (*Shënim i Engelsit për botimin anglisht të vitit 1888.*)

që ka përfunduar kurdoherë me një transformim revolucionar të gjithë godinës shoqërore ose me zhdukjen e përbashkët të klasave në luftë.

Në epokat e mëparshme historike ne gjejmë pothuajse kudo një ndarje të plotë të shoqërisë në shtresa të ndryshme, — një shkallë të tërë gjendjesh të ndryshme shoqërore. Në Romën e Vjetër ne gjejmë patricët, kalorësit, plebejtë, skllëverit; në mesjetë — zotërinjtë feudale, vasalët, mjeshtrit e esnafëve, shegertët, bujkrobërit dhe, për më tepër, gati në secilën nga këto klasa — edhe shkallëzime të veçanta.

Shoqëria e sotme borgjeze, që doli nga gjiri i shoqërisë së përmbysur feudale, nuk i zhduku kontradiktat e klasave. Ajo s'bëri gjë tjetër veçse solli klasa të reja, kushte të reja shtypjeje dhe forma të reja lufte në vend të të vjetrave.

Por epoka jonë, epoka e borgjezisë, — dallohet sepse ajo i thjeshtoi kontradiktat e klasave: shoqëria vjen duke u ndarë gjithnjë më tepër në dy kampe të mëdha armiqësore, në dy klasa të mëdha, që qëndrojnë njëra kundër tjetrës — në borgjezi dhe në proletariati.

Nga bujkrobërit e mesjetës doli popullsia e lirë e qyteteve të para; nga kjo shtresë qytetarësh u zhvilluan elementët e parë të borgjezisë.

Zbulimi i Amerikës dhe i rrugës detare rreth Afrikës krijoi një fushë të re veprimtarie për borgjezinë që po rritej. Tregu i Indisë Lindore dhe ai i Kinës, kolonizimi i Amerikës, këmbimi me kolonitë, shtimi i sasisë së mjeteve të këmbimit dhe i mallrave në përgjithësi i dhanë tregëtisë, lundrimin, industrisë një hov që s'ishte parë deri atëherë dhe shkaktuan në këtë mënyrë zhvillimin e shpejtë të elementit revolucionar në gjirin e shoqërisë feudale që po shkatërrohej.

Organizimi i mëparshëm i industrisë mbi baza feudale ose mbi baza esnafesh nuk mund t'i plotësonte më kërkesat që shtoheshin bashkë me tregjet e reja. Vendin e tij e zuri manufaktura. Vendin e mjeshtërve të esnafëve e zuri shtresa e mesme industriale; ndarja e punës midis korporatave të ndryshme u zhduk, duke i lëshuar vendin ndarjes së punës brenda çdo punishteje të veçantë.

Por tregjet gjithnjë shtoheshin, gjithnjë shtoheshin edhe kërkesa. Atë nuk ishte në gjendje ta plotësonte as edhe manufaktura. Atëherë avulli dhe maqina bënë një revolucion në industri. Vendin e manufakturës e zuri industria e madhe mo-

derne, vendin e shtresës së mesme industriale e zunë industrialet milionerë, prijësit e ushtrive të mëdha industriale, borgjezët e sotëm.

Industria e madhe krijoi tregun botëror, të cilin e kishte pregatitur zbulimi i Amerikës. Tregu botëror bëri që të zhvilloheshin pa masë tregëtia, lundrimi dhe mjetet e komunikacionit tokësor. Kjo gjë nga ana e vet influençoi në zgjerimin e industrisë; dhe sa më shumë përparonte industria, tregëtia, lundrimi dhe hekurudhat, aq më shumë zhvillohej edhe borgjezia, aq më shumë i shtonte ajo kapitalet e veta dhe i shtynte në plan të dytë të gjitha klasat e trashëguara nga mesjeta.

Ne shohim, pra, se vetë borgjezia e sotme është produkt i një procesi të gjatë zhvillimi, i një vargu përmbysjesh në mënyrën e prodhimit dhe të këmbimit.

Secila nga këto etapa të zhvillimit të borgjezisë është shoqëruar nga suksesi politik përkatës. Shtresë e shtypur në kohën e sundimit të feudalëve, shoqatë e armatosur dhe autonome në komunë*, këtu — republikë e pavarur bashkiake, atje — shtresë e tretë**, nga e cila monarkia nxirrte tatimet***, pastaj në periudhën e manufakturës, — kundërpeshë përballë fisnikëve në monarkinë e kufizuar ose absolute, dhe në përgjithësi bazë kryesore e monarkive të mëdha, më në fund, me krijimin e industrisë së madhe dhe të tregut botëror, borgjezia arriti të

* «Komuna» quheshin në Francë qytetet që lindën edhe përpara se ato të kishin fituar vetëqeverisjen lokale dhe të drejtat politike të «shtresës së tretë» në luftë kundër sunduesve dhe padronëve të tyre feudalë. Duke folur në përgjithësi, këtu si vend tipik i zhvillimit ekonomik të borgjezisë është marrë Anglia dhe si vend tipik i zhvillimit politik — Franca. (Shënim i Engelsit për botimin anglisht të vitit 1888.)

Komunë — kështu e quanin qytetarët e Italisë dhe të Francës bashkarinë e tyre qytetare, pasi ua blenë feudalëve ose i fituan në luftë kundër tyre të drejtat e para të vetëqeverisjes. (Shënim i Engelsit për botimin gjermanisht të vitit 1890.)

** Shtresë e tretë (përkthim nga frëngjishtja: tiers état) — quhej në Francë, para revolucionit të vitit 1789, popullsia e paprivilegjuar e qytetit dhe e fshatit (kryesisht qytetarët, borgjezia, bogjezia e vogël) për ta dalluar atë nga kleri dhe nga fisnikët. Red. Përkth.

*** Në botimin anglisht të vitit 1888 të redaktuar nga Engelsi pas fjalëve: «republikë e pavarur bashkiake» janë shtuar fjalët: «(si në Itali dhe në Gjermani)» dhe pas fjalëve: «shtresë e tretë, nga e cila monarkia nxirrte tatimet» — «(si në Francë)». Red.

vendoste sundimin e vet të plotë politik në shtetin e sotëm parlamentar. Pushteti i sotëm shtetëror s'është gjë tjetër veçse një komitet që administron punët e përbashkëta të gjithë klasës së borgjezisë.

Borgjezia ka luajtur në histori një rol jashtëzakonisht revolucionar.

Kudo që ka marrë fuqinë, borgjezia i ka shkatërruar të gjitha marrëdhëniet feudale, patriarkale, idilike. Ajo i bëri copë pa mëshirë prangat e shumëllojshme feudale, që e lidhnin njeriun me «eporët e natyrshëm» të tij, dhe nuk la midis njerëzve asnjë lidhje tjetër veç interesit të zhveshur, veç pagesës së pashpirt me para në dorë. Ajo i mbyti në ujin e akullit të llogarisë egoiste drithmat e shenjta të ekstazës fetare, të entuziazmit kalorsiak dhe të sentimentalizmit mikroborgjez. Ajo e shndërroi dinjitetin personal të njeriut në një vlerë këmbimi dhe në vend të lirive të panumërta, të fituara pas aq përpjekjesh e mundimesh, vuri vetëm lirinë e paturpshme të tregëtisë. Me një fjalë, shfrytëzimin e mbuluar me iluzione fetare dhe politike ajo e zëvendësoi me shfrytëzimin e hapët, të paturpshëm, të drejtpërdrejtë dhe brutal.

Borgjezia ua hoqi aureolën e shenjtë të gjitha llojeve të veprimtarisë, që deri në atë kohë gëzonin nder dhe respekt të thellë. Mjekun, juristin, priftin, poetin dhe shkencëtarin ajo i shndërroi në punëtorë të saj me mëditje.

Borgjezia e grisi cipën e sentimentalizmit të ëmbël që mbulonte marrëdhëniet familjare dhe i ktheu këto në marrëdhënie të thjeshta monetare.

Borgjezia tregoi se forca brutale, që përdorej në mesjetë dhe që reaksionarët e admirojnë aq shumë, gjente plotësimin e saj të natyrshëm në përtesën dhe në plogështinë. Ajo për të parën herë tregoi se ç'mund të bëjë puna e njeriut. Ajo bëri mrekulli në art, por të tilla që ndryshojnë krejtësisht nga piramidet e Egjiptit, nga ujësjellësit e Romës dhe nga katedralet gotike; ajo bëri fushata, por të tilla që ndryshojnë krejtësisht nga dyndjet e popujve dhe nga kryqëzatat.

Borgjezia nuk mund të ekzistojë pa shkatërruar vazhdimisht përmbysje në veglat e prodhimit, pa revolucionuar, pra, marrëdhëniet në prodhim, dhe, si rrjedhim, të gjitha marrëdhëniet shoqërore. Përkundrazi, kushti i parë për ekzistencën e të gjitha klasave industriale të mëparshme ishte që mënyra e vjetër e prodhimit të mbetej e pandryshuar. Përmbysjet e vazhduesh-

me në prodhim, tronditja e vazhdueshme e të gjitha marrëdhënieve shoqërore, pasiguria e përhershme dhe lëvizja janë ato që e dallojnë epokën borgjeze nga të gjitha epokat e mëparshme. Të gjitha marrëdhëniet që nuk zhvillohen më dhe që kanë zënë ndryshk, së bashku me përfytyrimet dhe me pikëpamjet që i shoqërojnë e që koha i ka shenjtëruar, shkatërrohen, të gjitha ato që lindin rishtazi vjetrohen pa arritur ende të zënë vend. Çdo gjë që nuk zhvillohet më, çdo gjë që ka të bëjë me kastet mesjetare, tani zhduket, çdo gjë e shenjtë profanohet, dhe njerëzit, më në fund, e kuptojnë se duhet t'i shohin kushtet e veta të jetesës dhe marrëdhëniet e veta reciproke ashtu siç janë.

Nevoja për të shitur vazhdimisht sa më tepër produkte e shtyn borgjezinë të shtrihet nëpër të gjithë rruzullin e dheut. Asaj i duhet të futet kudo, të hedhë baza kudo, të vendosë lidhje kudo.

Me anën e shfrytëzimit të tregut botëror borgjezia e bëri kozmopolit prodhimin dhe konsumin e të gjitha vendeve. Me gjithë hidhërimin e madh të reaksionarëve, ajo ia hoqi industrisë bazën e saj kombëtare. Degët e vjetra kombëtare të industrisë u asgjësuan dhe po asgjësohen çdo ditë. Vendin e tyre e zënë degë të reja të industrisë, ngritja e të cilave po bëhet një çështje jete për të gjitha kombet e qytetëruara, — ato degë të industrisë që përpunojnë tashmë jo lëndët e para të vendit, por lëndët e para të sjella nga viset më të largëta të rruzullit të dheut dhe që prodhojnë produkte të fabrikuar, të cilat konsumohen jo vetëm brenda vendit, por edhe në të gjitha kontinentet. Në vend të nevojave të vjetra, që plotësoheshin me produktet kombëtare, lindin nevoja të reja, për plotësimin e të cilave lypsen produktet e vendeve më të largëta dhe të klimave më të ndryshme. Vendin e veçimit të dikurshëm lokal dhe kombëtar dhe të jetesës me anën e produkteve të prodhimit vendas e zënë lidhjet e gjithanshme midis kombeve dhe varësia e tyre e gjithanshme, reciproke. Kjo mund të thuhet si për prodhimin material, ashtu edhe për prodhimin shpirtëror. Frytet e veprimtarisë shpirtërore të kombeve të veçanta bëhen pronë e përbashkët. Njëanësia dhe veçimi kombëtar bëhen dita-ditës më të pamundshëm, kështu që nga letërsitë e shumta kombëtare dhe lokale formohet një letërsi e vetme botërore.

Duke përmirësuar në mënyrë të shpejtë të gjitha veglat e prodhimit, duke e bërë jashtëzakonisht të lehtë komunikacionin,

borgjezia vë në rrugën e qytetërimit edhe kombet më barbare. Çmimet e ulëta të mallrave të saj — ja artilleria e rëndë, me anën e së cilës ajo shkatërron të gjitha muret kineze dhe bën që të kapitulojë urrejtja më e fortë e barbarëve kundrejt të huajve. Ajo i shtërngon të gjitha kombet të pranojnë mënyrën borgjeze të prodhimit, i shtërngon të fusin në vendin e tyre të ashtuquajturin qytetërim, d.m.th. të bëhen borgjezë, po nuk deshën të shkatërrohen. Me një fjalë, ajo krijon një botë sipas fytyrës dhe shembëlltyrës së vet.

Borgjezia e vuri fshatin nën sundimin e qytetit. Ajo krijoi qytete shumë të mëdha, e shtoi pa masë popullsinë qytetare në krahasim me popullsinë fshatare dhe e nxori kështu një pjesë të madhe të popullsisë nga idiotizmi i jetës fshatare. Ashtu sikurse e vuri fshatin nën varësinë e qytetit, ashtu i vuri ajo edhe vendet barbare e gjysmëbarbare nën varësinë e vendeve të qytetëruara, popujt fshatarë — nën varësinë e popujve borgjezë, Lindjen — nën varësinë e Perëndimit.

Borgjezia po e zhduk gjithnjë më tepër copëtimin e mjeteve të prodhimit, të pronës dhe të popullsisë. Ajo e dendësoi popullsinë, centralizoi mjetet e prodhimit, koncentroi pronën në pak duar. Pasojë e pashmangshme e kësaj që centralizimi politik. Krahuina të pavarura, të lidhura në mes tyre pothuajse vetëm me anë lidhjesh federale, krahuina me interesa, ligje, qeveri e tarifa doganore të ndryshme, u bashkuan në një komb të vetëm me një qeveri të vetme, me një legjislacion të vetëm, me një interes klasor kombëtar të vetëm, me një kufi doganor të vetëm.

Borgjezia në më pak se njëqind vjet sundimi si klasë krijoi forca prodhuese më të shumta në numër dhe më të mëdha se ato që kishin krijuar gjithë brezat e mëparshëm të marrë së bashku. Nënshtrimi i forcave të natyrës, prodhimi me anën e makinave, përdorimi i kimisë në industri dhe në bujqësi, lundrimi me avull, hekurudhat, telegrafi elektrik, shndërrimi i kontinenteve të tëra në toka të përshtatshme për bujqësi, rregullimi i lumenjve për lundrim, masa të tëra popullsie që dalin si me magji mbi dhe, — cili nga shekujt e mëparshëm mund të parandjente se në gjirin e punës shoqërore fshiheshin forca prodhuese kaq të mëdha?

Pamë, pra, se mjetet e prodhimit dhe të këmbimit, mbi bazën e të cilave u formua borgjezia, u krijuan në gjirin e shoqërisë feudale. Në një shkallë të caktuar të zhvillimit të këtyre

mjeteve të prodhimit dhe të këmbimit, marrëdhëniet, brenda të cilave zhvilloheshin prodhimi dhe këmbimi i shoqërisë feudale, organizimi feudal i bujqësisë dhe i industrisë, me një fjalë, marrëdhëniet feudale të pronësisë, nuk u përgjigjeshin më forcave prodhuese që tani ishin zhvilluar. Ato, në vend që ta zhvillonin prodhimin, u bënë një pengesë për të. Ato u shndërruan në pranga për të. Këto pranga duheshin këputur, dhe u këputën.

Vendin e tyre e zuri konkurrenca e lirë me rendin shoqëror dhe politik që i përgjigjet asaj, me sundimin ekonomik dhe politik të klasës së borgjezisë.

Para syve tanë po kryhet i njëjti proces. Shoqëria e sotme borgjeze, me marrëdhëniet e saj borgjeze të prodhimit dhe të këmbimit, me marrëdhëniet borgjeze të pronësisë, shoqëri që krijoi si me magji mjete kaq të fuqishme prodhimi dhe këmbimi, i përngjet magjistarit, i cili s'është më në gjendje t'i shtrojë forcat e nëndheshme që i ka thirrur vetë. Ka tashmë disa dhjetëra vjet që historia e industrisë dhe e tregëtisë s'është gjë tjetër veçse historia e revoltimit të forcave prodhuese të sotme kundër marrëdhënieve të sotme në prodhim, kundër atyre marrëdhënieve të pronësisë që janë kusht për ekzistencën e borgjezisë dhe për sundimin e saj. Mjafton të përmenden krizat tregëtare, të cilat, duke u përsëritur periodikisht, vënë në rrezik gjithnjë më shumë ekzistencën e gjithë shoqërisë borgjeze. Në kohën e krizave tregëtare çdo herë asgjësohet një pjesë e madhe jo vetëm e produkteve të gatshme, por edhe e forcave prodhuese që janë krijuar qysh më parë. Në kohën e krizave shpërthen një epidemi shoqërore, e cila të gjitha epokave të mëparshme do t'u dukej si një marrëzi, — epidemia e superprodhimit. Befas shoqëria hidhet prapa në një gjendje barbarie të ardhur papritmas; duket sikur një zi, një luftë e përgjithshme shfarosëse i ka hequr çdo mjet jetese shoqërisë; duket sikur industria dhe tregëtia janë asgjësuar, — dhe përse? Sepse shoqëria ka arritur një qytetërim tepër të madh, ka mjete jetese me tepricë, ka një industri dhe një tregëti tepër të madhe. Forcat prodhuese që ndodhen në dispozicion të saj nuk i shërbejnë më zhvillimit të marrëdhënieve borgjeze të pronësisë; përkundrazi, ato janë bërë tepër të mëdha për këto marrëdhënie, marrëdhëniet borgjeze e pengojnë zhvillimin e tyre; dhe kur forcat prodhuese fillojnë t'i kapërcejnë këto pengesa, ato e bëjnë rrëmujë gjithë shoqërinë bor-

gjeze, vënë në rrezik ekzistencën e pronës borgjeze. Marrëdhëniet borgjeze janë bërë tepër të ngushta për t'u gjetur vend pasurive të krijuara prej tyre. — Me ç'mënyrë i kapërcen krizat borgjezia? Nga njëra anë, duke shkatërruar me përdhunë një sasi të madhe forcash prodhuese, nga ana tjetër, duke pushtuar tregje të reja dhe duke shfrytëzuar më mirë të vjetrat. Me ç'mënyrë, pra? Duke përgatitur kriza më të gjera dhe më shkatërrimtare dhe duke i pakësuar mjetet e luftës kundër tyre.

Arma, me të cilën borgjezia përmbysi feudalizmin, tani kthehet kundër vetë borgjezisë.

Por borgjezia nuk farkëtoi vetëm armën që po i sjell asaj vdekjen; ajo krijoi edhe njerëzit që do ta drejtojnë kundër saj këtë armë, — punëtorët e sotëm, *proletarët*.

Në atë shkallë që zhvillohet borgjezia, d.m.th. kapitali, zhvillohet edhe proletariati, klasa e punëtorëve të sotëm, të cilët mund të rrojnë vetëm kur gjejnë punë, dhe gjejnë punë vetëm kur puna e tyre shton kapitalin. Këta punëtorë, që detyrohen ta shesin veten me copë, janë një mall tregu, si të gjitha mallrat e tjera, dhe prandaj janë në mëshirën e të gjitha të papriturave të konkurrencës, e të gjitha lëkundjeve të tregut.

Me përhapjen e përdorimit të maqinave dhe me zhvillimin e ndarjes së punës, puna e proletarëve humbi çdo karakter të pavarur dhe, njëkohësisht, edhe çdo gjë tërheqëse për punëtorin. Punëtori bëhet një shtojcë e thjeshtë e maqinës, prej tij s'kërkohen veçse veprime fare të thjeshta monotone, që mund të mësohen fare lehtë. Prandaj shpenzimet që bëhen për punëtorin kufizohen pothuajse vetëm me mjetet e jetesës që i nevojiten atij për t'u mbajtur gjallë dhe për t'u shumuar. Por çmimi i çdo malli, pra edhe i punës*, është i barabartë me shpenzimet e prodhimit të tij. Prandaj, sa më pak tërheqëse bëhet puna, aq më shumë pakësohet paga. Për më tepër: po në atë masë që shtohet përdorimi i maqinave dhe ndarja e punës, shtohet edhe sasia e punës**, qoftë për shkak të shti-

* Në veprat e mëvonshme Marks i dhe Engelsi kanë përdorur në vend të nocioneve «vlerë e punës», «çmim i punës» nocione më të sakta, të futura nga Marks i, — «vlerë e fuqisë punëtore», «çmim i fuqisë punëtore» (shih hyrjen e Engelsit për veprën e Marksit «Puna me mëditje dhe kapitali»). *Red.*

** Në botimin anglisht të vitit 1888 në vend të fjalëve: «sasia e punës» është shkruar: «pesha e punës». *Red.*

mit të orëve të punës, apo për shkak të shtimit të sasisë së punës që nevojitet në çdo interval të dhënë kohe, të shtimit të shpejtësisë së maqinave etj.

Industria e sotme e shndërroi punishten e vogël të mjeshtërtrit patriarkal në një fabrikë të madhe të kapitalistit industrial. Masa punëtorësh, të grumbulluara në fabrikë, organizohen në mënyrë ushtarake. Si ushtarë të armatës industriale, ata vihen nën mbikëqyrjen e një hierarkie të tërë nënoficerësh dhe oficerësh. Ata nuk janë vetëm skllëvër të klasës borgjeze, të shtetit borgjez; ata i robëron çdo ditë e çdo orë maqina e tyre, mbikëqyrësi dhe, para së gjithash, vetë fabrikanti borgjez. Sa më haptazi shpallet fitimi si qëllim i këtij despotizmi, aq më i ulët, më i urryer, më i egër bëhet ky despotizëm.

Sa më pak shkathtësi dhe forcë kërkon puna e dorës, d.m.th. sa më tepër zhvillohet industria e sotme, aq më tepër puna e burrave zëvendësohet nga puna e grave dhe e fëmijëve. Përsa i përket klasës punëtore, ndryshimet e seksit dhe të moshës humbasin çdo vlerë shoqërore. Ekzistojnë vetëm vegla pune, që kërkojnë shpenzime të ndryshme sipas moshës dhe seksit.

Kur mbaron shfrytëzimi i punëtorit nga fabrikanti dhe punëtori, më në fund, merr pagën në të holla, mbi të vërsulen pjesëtarë të tjerë të borgjezisë — pronari i shtëpisë, bakalli, fajdexhiu etj.

Shtresat e ulëta të klasave të mesme: industrialët e vegjël, tregëtarët e vegjël dhe rantierët, zejtarët dhe fshatarët — të gjithë këta zbresin në radhët e proletariatit, pjesërisht sepse kapitali i tyre i vogël nuk mjafton për të mbajtur ndërmarrje të mëdha industriale dhe nuk mund t'i bëjë ballë konkurrencës me kapitalistët më të mëdhenj, pjesërisht sepse mjeshtëria e tyre profesionale zhvleftësohet nga metodat e reja të prodhimit. Kështu proletariati shton radhët e veta nga të gjitha klasat e popullsisë.

Proletariati kalon faza të ndryshme në zhvillimin e vet. Lufta e tij kundër borgjezisë fillon bashkë me ekzistencën e tij.

Në fillim luftojnë punëtorë të veçantë, pastaj punëtorët e një fabrike, më vonë punëtorët e një dege të punës në një krahinë të veçantë kundër një borgjezi të veçantë, i cili i shfrytëzon drejt për së drejti. Punëtorët i drejtojnë sulmet e veta

jo vetëm kundër marrëdhënieve borgjeze në prodhim, por edhe kundër vetë veglave të prodhimit; ata asgjësojnë mallrat e huaja që i konkurrojnë, shkatërrojnë maqinat, u vënë zjarrin fabrikave dhe përpiqen të rifitojnë me forcë pozitën e humbur të punëtorit mesjetar.

Në këtë fazë punëtorët formojnë një masë të përndarë nëpër të gjithë vendin dhe të copëtuar nga konkurrenca. Bashkimi i masave punëtore nuk është ende pasojë e bashkimit të organizuar nga ata vetë, por vetëm pasojë e bashkimit të borgjezisë, e cila, për të arritur qëllimet e veta politike, është e detyruar të vërë në lëvizje gjithë proletariatin, dhe këtë ajo ka ende mundësi ta bëjë. Pra, në këtë fazë proletarët luftojnë jo kundër armiqve të vet, por kundër armiqve të armiqve të tyre — kundër mbeturinave të monarkisë absolute, kundër çifligarëve, kundër borgjezëve joindustrialë, kundër borgjezëve të vegjël. Kështu, gjithë lëvizja historike përqëndrohet në duart e borgjezisë; çdo fitore e korrur në kushte të tilla është fitore e borgjezisë.

Por me zhvillimin e industrisë proletariati shtohet jo vetëm në numër; ai grumbullohet në masa të mëdha, forca e tij vjen duke u rritur, dhe ai fillon ta ndjejë këtë gjithnjë më tepër. Interesat e proletariatit dhe kushtet e tij të jetesës nivelohen gjithnjë më tepër, sepse maqina i zhdok gjithnjë më tepër ndryshimet midis llojeve të veçanta të punës dhe pagën e zbret pothuajse kudo në një nivel të ulët, të njëjlojtë për të gjithë. Konkurrenca gjithnjë më e madhe që bëjnë borgjezët midis tyre dhe krizat tregëtare të shkaktuara prej saj bëjnë që paga e punëtorëve të jetë gjithnjë e paqëndrueshme; përmirësimi i parreshtur dhe gjithmonë më i vrullshëm i maqinave e bën gjithnjë më të vështirë jetesën e proletarëve; konfliktet midis punëtorëve të veçantë dhe borgjezëve të veçantë marrin gjithnjë më tepër karakterin e konflikteve midis dy klasave. Punëtorët fillojnë të formojnë koalicione* kundër borgjezëve; ata luftojnë së bashku për të mbrojtur pagën e vet. Ata arrijnë të formojnë edhe shoqata të përhershme për të siguruar mjetet që u nevojiten në rast konfliktesh eventuale. Aty-këtu kjo luftë kthehet në kryengritje të hapëta.

Kohë pas kohe punëtorët fitojnë, por këto fitore s'janë veçse

* Në botimin anglisht të vitit 1888 pas fjalës: «koalicione» është shtuar: «(bashkime profesionale)». Red.

të përkohshme. Rezultati i vërtetë i luftës së tyre nuk është suksesi imediat, por bashkimi i punëtorëve, që merr përpjesëtime gjithnjë më të gjera. Këtë bashkim e favorizojnë mjetet e komunikacionit gjithnjë më të zhvilluara, të cilat i krijojnë industria e madhe dhe të cilat vendosin lidhjet midis punëtorëve të viseve të ndryshme. Mjaftojnë vetëm këto lidhje që të përqëndrohen shumë nga vatrave lokale të luftës, e cila ka kudo karakter të njëlojtë, dhe të shkrihen ato në një luftë të vetme kombëtare, klasash. Mirëpo, çdo luftë klasash është një luftë politike. Dhe bashkimi, për të cilin qytetarëve të mesjetës, me rrugët e vogla lokale, u duheshin shekuj të tërë, arrihet nga proletarët e sotëm, në saje të hekurudhave, brenda pak vjetësh.

Ky organizim i proletarëve në klasë, dhe njëkohësisht — në parti politike, vjen e thuhet rishtazi çdo çast nga konkurrenca midis vetë punëtorëve. Por ai lind përsëri dhe përsëri, duke u bërë çdo herë më i fortë, më i shëndoshë, më i fuqishëm. Duke shfrytëzuar grindjet midis shtresave të ndryshme të borgjezisë, ky organizim e shtërngon borgjezinë të njohë me ligj disa interesa të punëtorëve. Për shembull, ligji mbi ditën 10-orëshe të punës në Angli.

Konfliktet në gjirin e shoqërisë së vjetër në shumë pikëpamje e ndihmojnë procesin e zhvillimit të proletariatit. Borgjezia është në një luftë të vazhdueshme: në fillim kundër aristokracisë, më vonë kundër atyre pjesëve të vetë borgjezisë, interesat e të cilave bien në kundërshtim me përparimin e industrisë, dhe gjithmonë — kundër borgjezisë së të gjitha vendeve të huaja. Në të gjitha këto beteja ajo është e detyruar t'i drejtohet proletariatit, t'i kërkojë ndihmë dhe ta hedhë kështu në lëvizjen politike. Pra, vetë ajo i jep proletariatit elementet e arësimit të vet*, d.m.th. një armë kundër vetes së saj.

Pastaj, sikurse pamë më lart, përparimi i industrisë hedh në radhët e proletariatit shtresa të tëra të klasës sunduese, ose, të paktën, vë në rrezik kushtet e jetesës së tyre. Edhe këto i sjellin proletariatit një sasi të madhe elementesh arësimi**.

* Në botimin anglisht të vitit 1888 në vend të fjalëve «elementet e arësimit të vet» është shkruar: «elementet e arësimit të vet politik dhe të arësimit të përgjithshëm». Red.

** Në botimin anglisht të vitit 1888 në vend të fjalëve: «elementesh arësimi» është shkruar: «elementesh arësimi dhe përparimi». Red.

Më në fund, në ato periudha, kur lufta e klasave i afrohet çastit vendimtar, procesi i dekompozimit brenda klasës sunduese, brenda gjithë shoqërisë së vjetër, bëhet aq i vrullshëm, aq i ashpër, saqë një pjesë e vogël e klasës sunduese shkëputet prej kësaj dhe bashkohet me klasën revolucionare, me atë klasë së cilës i përket e ardhmja. Ja përse, ashtu sikurse më parë një pjesë e fisnikëve mori anën e borgjezisë, ashtu edhe tani një pjesë e borgjezisë merr anën e proletariatit, pikërisht — pjesa e ideologëve borgjezë, të cilët kanë arritur ta kuptojnë teorikisht gjithë zhvillimin historik.

Nga të gjitha klasat që sot qëndrojnë përballë borgjezisë, vetëm proletariati është një klasë me të vërtetë revolucionare. Të gjitha klasat e tjera bien dhe zhduken me zhvillimin e industrisë së madhe, ndërsa proletariati është pikërisht produkt i saj.

Shtresat e mesme: industrialitë i vogël, tregëtari i vogël, zeytari dhe fshatari — të gjithë këta luftojnë kundër borgjezisë për të shpëtuar ekzistencën e vet si shtresa të mesme. Pra, ata nuk janë revolucionarë, por konservatorë. Bile edhe më tepër, janë reaksionarë: ata përpiqen ta kthejnë prapa rrotën e historisë. Në janë revolucionarë, janë vetëm përderisa ata do të kalojnë në të ardhmen në radhët e proletariatit, përderisa ata nuk mbrojnë interesat e veta të tashme, por interesat e veta të ardhshme, përderisa ata braktisin pikëpamjen e vet për të përqaftuar pikëpamjen e proletariatit.

Lumpenproletariati, ky produkt pasiv i kalbëzimit të shtresave më të ulëta të shoqërisë së vjetër, aty-këtu vihet në lëvizje nga revolucionj proletar, por për shkak të vetë kushteve të tij të jetesës ai është më i gatshëm të shesë veten për t'u vënë në shërbim të intrigave reaksionare.

Kushtet e jetesës së shoqërisë së vjetër janë asgjësuar tashmë në kushtet e jetesës së proletariatit. Proletari nuk ka pronë; marrëdhëniet e tij me gruan dhe me fëmijët nuk kanë më asgjë të përbashkët me marrëdhëniet familjare borgjeze; puna e sotme industriale, zgjedhja e sotme e kapitalit, që është e njëlojtë si në Angli, ashtu edhe në Francë, si në Amerikë, ashtu edhe në Gjermani, s'i kanë lënë atij asgjë nacionale. Ligjet, morali, feja — të gjitha këto s'janë për të veçse paragjykime borgjeze, prapa të cilave fshihen interesat e borgjezisë.

Të gjitha klasat e mëparshme, pasi shtinin në dorë fuqinë,

përpiqeshin t'i forconin pozitativ e fituara në jetë duke ua nënshtruar gjithë shoqërinë kushteve që mund të siguronin mënyrën e tyre të përvetësimit. Kurse proletarët mund t'i shtien në dorë forcat prodhuese të shoqërisë vetëm pasi ta kenë asgjësuar mënyrën e tyre të sotme të përvetësimit, dhe njëkohësisht gjithë mënyrën e përvetësimit që ka ekzistuar deri më sot. Proletarët s'kanë asgjë të vetën për të ruajtur, ata duhet të shkatërrojnë çdo gjë që ka ruajtur dhe ka siguruar deri më sot pronën private.

Të gjitha lëvizjet që kanë ndodhur deri më sot, kanë qenë lëvizje të pakicës, ose janë bërë në interes të pakicës. Lëvizja proletare është lëvizje e pavarur e shumicës dërmuese në interes të shumicës dërmuese. Proletariati, shtresa më e ulët e shoqërisë së sotme, nuk mund të ngrihet, nuk mund të mëkëmbet, po nuk u hodh në erë gjithë superstruktura që i rri përsipër dhe që formohet nga shtresat që përbëjnë shoqërinë zyrtare.

Në mos nga përmbajtja, nga forma lufta e proletariatit kundër borgjezisë në filim është një luftë kombëtare. Proletariati i çdo vendi duhet, sigurisht, më parë t'i qërojë hesapet me borgjezinë e vet.

Duke përshkruar fazat më të përgjithshme të zhvillimit të proletariatit, ne analizuam luftën civile pak a shumë të maskuar, që zhvillohet në gjirin e shoqërisë ekzistuese deri në atë pikë kur ajo shndërrohet në revolucion të hapët, dhe proletariati e vendos sundimin e vet duke përmbysur me forcë borgjezinë.

Të gjitha shoqëritë që kanë ekzistuar deri më sot kanë pasur si bazë, sikurse pamë, antagonizmin midis klasave shtypëse dhe klasave të shtypura. Por, që të mund të shtypet një klasë, duhen siguruar kushtet në të cilat ajo të mund të bëjë të paktën një jetë të mjeruar prej skllavi. Bujkrobi në rendin e bujkobërisë arrinte të bëhej anëtar i komunës, ashtu si dhe borgjezi i vogël nën zgjedhën e absolutizmit feudal arrinte të bëhej borgjez. Përkundrazi, punëtori i sotëm, me përparimin e industrisë, nuk ngrihet, por bie gjithnjë më poshtë, më poshtë se kushtet e ekzistencës së klasës së tij. Punëtori bëhet pauper, dhe pauperizmi shtohet edhe më shpejt se popullsia dhe pasuria. Kjo tregon qartë se borgjezia nuk është e aftë të qëndrojë më gjatë si klasë sunduese e shoqërisë dhe t'ia imponojë gjithë shoqërisë kushtet e ekzistencës

së klasës së vet si një ligj rregullues. Ajo nuk është e aftë të sundojë, sepse nuk është e aftë t'i sigurojë skllavit të vet qoftë edhe një nivel jetese prej skllavi, sepse është e shtërnguar ta lërë atë të katandiset në një gjendje të atillë, saqë do t'i duhet pastaj ta ushqejë atë, në vend që të ushqehet prej tij. Shoqëria nuk mund të jetojë më nën pushtetin e saj, d.m.th. jeta e saj nuk pajtohet më me shoqërinë.

Kushti kryesor i ekzistencës dhe i sundimit të klasës së borgjezisë është grumbullimi i pasurisë në duart e njerëzve të veçantë, formimi dhe shtimi i kapitalit. Kusht i ekzistencës së kapitalit është puna me mëditje. Puna me mëditje mbështetet kryekëput në konkurrencën e punëtorëve midis tyre. Përparimi i industrisë, bartëse e të cilit është padashur borgjezia që nuk është në gjendje ta kundërshtojë, në vend të përçarjes së punëtorëve nga konkurrenca sjell bashkimin revolucionar të tyre me anën e organizimit në shoqata. Në këtë mënyrë, me zhvillimin e industrisë së madhe, borgjezia e humb bazën mbi të cilën ajo prodhon dhe përvetëson produktet. Ajo prodhon, në radhë të parë, varmihësit e vet. Zhdukja e saj dhe fitorja e proletariatit janë njëloj të pashmangshme.

II

PROLETARË DHE KOMUNISTË

Cila është pozita e komunistëve ndaj proletarëve në përgjithësi?

Komunistët nuk janë një parti e veçantë, e cila të qëndrojë përballë partive të tjera punëtore.

Ata nuk kanë aspak interesa të ndryshme nga interesat e gjithë proletariatit.

Ata nuk dalin me kurrfarë parimesh të veçanta*, mbi bazën e të cilave do të donin të organizonin lëvizjen proletare.

Komunistët ndryshojnë nga partitë e tjera proletare vetëm sepse, nga njëra anë, në luftën e proletarëve të kombeve të ndryshme ata nxjerrin në pah dhe mbrojnë interesat e përbashkëta të të gjithë proletariatit, të cilat nuk varen nga kombësia; nga ana tjetër, sepse në etapat e ndryshme të zhvillimit, përmes të cilave kalon lufta e proletariatit kundër borgjezisë, ata janë kurdoherë përfaqësuesit e interesave të lëvizjes në tërësi.

Pra, komunistët në praktikë janë pjesa më e vendosur e partive punëtore të të gjitha vendeve, ajo pjesë që nxit kurdoherë për të shkuar përpara**, kurse nga pikëpamja teorike ata qëndrojnë më lart se masa tjetër e proletariatit, sepse i kuptojnë kushtet, zhvillimin dhe rezultatet e përgjithshme të lëvizjes proletare.

Qëllimi imediat i komunistëve është po ai i të gjitha par-

* Në botimin anglisht të vitit 1888 në vend të fjalës: «të veçanta» është thënë: «sektare». Red.

** Në botimin anglisht të vitit 1888 në vend të fjalëve: «ajo pjesë që nxit kurdoherë për të shkuar përpara» është shkruar: «pjesa më e përparuar». Red.

tive të tjera proletare: formimi i proletariatit si klasë, përmbysja e sundimit të borgjezisë, marrja e pushtetit politik nga proletariati.

Tezat teorike të komunistëve nuk mbështeten aspak mbi ide, mbi parime, të shpikura ose të zbuluara nga ky ose ai përtëritës i botës.

Ato s'janë gjë tjetër veçse shprehja e përgjithshme e marrëdhënieve të vërteta të luftës së klasave në zhvillim e sipër, shprehja e lëvizjes historike që po kryhet përpara syve tanë, Zhdukja e marrëdhënieve të vjetra të pronësisë s'është diçka që karakterizon vetëm komunizmin.

Të gjitha marrëdhëniet e pronësisë vazhdimisht janë zëvendësuar me të tjera, vazhdimisht kanë ndryshuar gjatë historisë.

Për shembull, revolucionin francez* zhduku pronën feudale, duke e zëvendësuar atë me pronën borgjeze.

Tipari që e dallon komunizmin nuk është heqja e pronës në përgjithësi, por heqja e pronës borgjeze.

Por prona e sotme private borgjeze është shprehja e fundit dhe më e plotë e një prodhimi dhe përvetësimi të tillë të produkteve, që mbështetet në antagonizmat e klasave, në shfrytëzimin e disave prej disa të tjerëve**.

Nga kjo pikëpamje komunistët mund ta përmbledhin teorinë e vet me këtë tezë të vetme: zhdukja e pronës private.

Ne, komunistët, na kanë qortuar se duam të zhdukim pronën e fituar me punë personale, që është fryti i punës së secilit, atë pronë që përbën bazën e çdo lirie personale, bazën e çdo veprimtarie dhe pavarësie personale.

Pronë e fituar me mund dhe me punë! Mos e keni fjalën për pronën e borgjezit të vogël, e fshatarit të vogël, e cila ka ekzistuar para pronës borgjeze? Ne s'kemi pse ta zhdukim atë; atë e ka zhdukur dhe po e zhduk dita-ditës zhvillimi i industrisë.

Apo ndoshta ju e keni fjalën për pronën e sotme private borgjeze?

* Është fjala për revolucionin borgjez francez të vitit 1789. Red. Përkth.

** Në botimin anglisht të vitit 1888 në vend të fjalëve: «shfrytëzimin e disave prej disa të tjerëve» është shkruar: «shfrytëzimin e shumicës nga pakica». Red.

Por mos vallë puna me mëditje, puna e proletarit i krijon atij pronë? Në asnjë mënyrë. Ajo krijon kapital, d.m.th. një pronë që shfrytëzon punën me mëditje, një pronë që mund të shtohet vetëm në rast se ajo lind punë të re me mëditje, për ta shfrytëzuar atë përsëri. Prona në formën e saj të sotme lëviz në kontrastin midis kapitalit dhe punës me mëditje. Le t'i shohim të dyja anët e këtij kontrasti.

Të jesh kapitalist — do të thotë të kesh në prodhim jo vetëm një pozitë thjesht personale, por edhe një pozitë shoqërore. Kapitali është një produkt kolektiv dhe mund të vihet në lëvizje vetëm me anën e veprimtarisë së përbashkët të shumë anëtarëve të shoqërisë dhe, në fund të fundit — vetëm me veprimtarinë e përbashkët të të gjithë anëtarëve të shoqërisë.

Kapitali, pra, nuk është një forcë personale, por një forcë shoqërore.

Pra, në qoftë se kapitali do të bëhet pronë kolektive, e cila t'u përkasë të gjithë anëtarëve të shoqërisë, ky nuk do të jetë një shndërrim i pronës personale në pronë shoqërore. Do të ndryshojë vetëm karakteri shoqëror i pronës. Ajo do ta humbasë karakterin e vet klasor.

Le të kalojmë te puna me mëditje.

Cmimi mesatar i punës me mëditje është minimumi i pagës, d.m.th. shuma e mjeteve që i duhen punëtorit për të jetuar si punëtor. Pra, ajo që punëtori me mëditje përvetëson me veprimtarinë e vet, mezi mjafton për të riprodhuar jetën e tij. Ne nuk kemi aspak ndër mend ta zhdukim këtë përvetësim personal të produkteve të punës, që shërbejnë drejt për së drejti për të riprodhuar jetën, përvetësim që nuk lë asnjë tepricë, e cila do të mund të krijonte kushtet për të sunduar mbi punën e të tjerëve. Ne duam të zhdukim vetëm karakterin e shëmtuar të këtij përvetësimi, kur punëtori jeton vetëm për të shtuar kapitalin dhe jeton vetëm përderisa këtë e lypin interesat e klasës sunduese.

Në shoqërinë borgjeze puna e gjallë s'është veçse një mjet për të shtuar punën e akumuluar. Në shoqërinë komuniste puna e akumuluar s'është veçse një mjet për të zgjeruar, për të pasuruar dhe për të lehtësuar jetesën e punëtorëve.

Në këtë mënyrë, në shoqërinë borgjeze e kaluara sundon mbi të tashmen, në shoqërinë komuniste — e tashmja mbi të kaluarën. Në shoqërinë borgjeze kapitali gëzon pavarësi dhe

personalitet, kurse individit punonjës nuk ka as pavarësi dhe as personalitet.

Dhe zhdukjen e këtyre marrëdhënieve borgjezia e quan zhdukje të personalitetit dhe të lirisë! Ajo ka të drejtë. Me të vërtetë fjala është për zhdukjen e personalitetit borgjez, të pavarësisë borgjeze dhe të lirisë borgjeze.

Me fjalën liri, në kuadrin e marrëdhënieve të sotme borgjeze në prodhim, kuptohet liri e tregëtisë, liri e shitblerjes.

Por me zhdukjen e veprimtarisë tregëtare zhduket edhe veprimtaria e lirë tregëtare. Fjalët mbi veprimtarinë e lirë tregëtare, si edhe të gjitha fjalimet e tjera plot bujë të borgjezëve tanë mbi lirinë, në përgjithësi kanë kuptim vetëm po të krahasohen me veprimtarinë tregëtare jo të lirë, me qytetarin e shtypur të mesjetës, por jo me zhdukjen komuniste të veprimtarisë tregëtare, të marrëdhënieve borgjeze në prodhim dhe të vetë borgjezisë.

Ju tmerroheni kur mendoni se ne duam të zhdukim pronën private. Por në shoqërinë tuaj të sotme prona private është zhdukur për nëntë të dhjetat e anëtarëve të saj; ajo ekziston pikërisht sepse nuk ekziston për nëntë të dhjetat. Ju na qortoni, pra, se ne duam të zhdukim pronën, që nënkupton si kusht të domosdoshëm mungesën e pronës për shumicën dërmuese të shoqërisë.

Me një fjalë, ju na qortoni se ne duam të zhdukim pronën tuaj. Po, ne me të vërtetë duam ta bëjmë këtë.

Ju deklaroni se që nga çasti kur puna nuk do të kthehet më në kapital, në para, në rentë toke, shkurt — në një forcë shoqërore që mund të monopolizohet, d.m.th. që nga çasti kur prona personale nuk do të shndërrohet më në pronë borgjeze, — që nga ky çast, thoni ju, personaliteti do të zhduket.

Ju e pranoni, pra, se personaliteti ekziston vetëm për borgjezin, d.m.th. për pronarin borgjez. Është e vërtetë se një personalitet i tillë duhet patjetër të zhduket.

Komunizmi askujt nuk ia heq mundësinë që të përvetësojë produktet shoqërore, ai zhduk vetëm mundësinë që me anën e këtij përvetësimi të skllavërohet puna e të tjerëve.

Na bëjnë vërejtjen se gjoja me zhdukjen e pronës private do të pushojë çdo veprimtari dhe do të mbretërojë një përtaci e përgjithshme.

Po të ishte kështu, shoqëria borgjeze duhej të kishte mbarruar prej kohësh nga përtacia, sepse këtu ai që punon, nuk fi-

ton asgjë, kurse ai që nuk punon, fiton. Të gjitha këto përfundojnë në një tautologji si kjo: nuk ka më punë me mëditje, në goftë se nuk ekziston më kapitali.

Të gjitha vërejtjet që drejtohen kundër mënyrës komuniste të përvetësimit dhe të prodhimit të produkteve materiale, përfshijnë edhe përvetësimin dhe prodhimin e produkteve të punës mendore. Ashtu sikurse zhdukja e pronës me karakter klase kuptohet nga borgjezi si zhdukje e vetë prodhimit, ashtu edhe zhdukja e kulturës me karakter klase për të është e barabartë me zhdukjen e kulturës në përgjithësi.

Kultura, zhdukjen e së cilës ai vajton, për shumicën dërmuese të njerëzve s'është gjë tjetër veçse shndërrimi i tyre në një shtojcë të maqinës.

Por është e kotë të bëni fjalë me ne, derisa ju e gjykoni heqjen e pronës borgjeze sipas pikëpamjeve tuaja borgjeze mbi lirinë, kulturën, të drejtën etj. Vetë idetë tuaja janë produkt i marrëdhënieve borgjeze në prodhim dhe i marrëdhënieve borgjeze të pronësisë, po ashtu sikurse e drejta juaj s'është gjë tjetër veçse vullneti i klasës suaj i ngritur në ligj, vullnet, përmbajtja e të cilit përcaktohet nga kushtet materiale të jetesës së klasës suaj.

Këtë pikëpamje egoiste, që ju bën juve t'i shndërroni marrëdhëniet tuaja në prodhim dhe marrëdhëniet e pronësisë nga marrëdhënie historike, që duken e zhduken në procesin e zhvillimit të prodhimit, në ligje të përjetshme të natyrës dhe të arësyes, këtë pikëpamje ju e keni të përbashkët me të gjitha klasat që kanë sunduar më parë dhe që janë zhdukur. Kur vjen fjala për pronën borgjeze, ju nuk keni guxim të kuptoni atë që ju e kuptoni fort mirë kur bëhet fjalë për pronën e lashtë ose feudale.

Zhdukje e familjes! Edhe radikalët më të vendosur indinjohen nga ky qëllim i shëmtuar i komunistëve.

Mbi se bazohet familja e sotme, borgjeze? Mbi kapitalin, mbi fitimin privat. Familja në formën e saj më të zhvilluar ekziston vetëm për borgjezinë; por atë e plotëson mungesa e detyrueshme e familjes te proletarët dhe prostitucioni publik.

Me zhdukjen e këtyre të fundit do të zhduket, natyrisht, edhe familja borgjeze, dhe të gjitha së bashku do të zhduken me zhdukjen e kapitalit.

Apo mos vallë ju na qortoni se ne duam t'i japim fund

shfrytëzimit të fëmijëve nga ana e prindërve? Ne e pranojmë këtë krim.

Por ju thoni se, duke zëvendësuar edukatën shtëpiake me edukatën shoqërore, ne duam të zhdukim marrëdhëniet më të shtrenjta për njeriun.

Por mos vallë edukata juaj nuk përcaktohet nga shoqëria? Mos vallë ajo nuk përcaktohet nga marrëdhëniet shoqërore brenda të cilave ju edukoni, nga ndërhyrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shoqërisë me anën e shkollës etj.? Influenca e shoqërisë mbi edukatën nuk është një gjë e shpikur prej komunistëve; ata s'bëjnë tjetër veçse ndryshojnë karakterin e edukatës, e shkëpusin atë nga influenca e klasës sunduese.

Pallavrat borgjeze mbi familjen dhe edukatën, mbi marrëdhëniet plot dhemshuri midis prindërve dhe fëmijëve bëhen aq më të neveritshme, sa më tepër shkatërrohen të gjitha lidhjet familjare në radhët e proletariatit, për shkak të zhvillimit të industrisë së madhe, sa më tepër shndërrohen fëmijët në artikuj të thjeshtë tregëtie dhe në vegla pune.

Por ju, komunistët, doni të vendosni bashkësinë e grave, — çirret njëzëri gjithë borgjezia.

Borgjezi e sheh gruan e vet si një vegël të thjeshtë prodhimi. Ai dëgjon se veglat e prodhimit do të përdoren së bashku, dhe, sigurisht, nuk mund të rrijë pa menduar se i njëjti fat i pret edhe gratë.

Atij as që i vete mendja se fjala është pikërisht për ta zhdukur atë gjendje të gruas, në të cilën ajo është një vegël e thjeshtë prodhimi.

Madje s'ka gjë më qesharake se sa tmerrri i borgjezëve tanë plot moral në lidhje me të ashtuquajturën bashkësi zyrtare të grave, që predikojnë komunistët. Komunistët s'kanë nevojë të vendosin bashkësinë e grave: ajo ka ekzistuar pothuajse gjithmonë.

Borgjezëve tanë nuk u mjafton që kanë në dispozicion gratë dhe vajzat e punëtorëve të vet, pa bërë fjalë këtu për prostitucionin zyrtar, prandaj ata ndajnë një kënaqësi të veçantë kur bëjnë për vete gratë e njëri-tjetrit.

Martesa borgjeze, në të vërtetë, është bashkësi grash. Shumë-shumë komunistët mund të qortoheshin se duan gjoja që bashkësia e fshehur dhe hipokrite e grave të zëvendësohet nga një bashkësi zyrtare, e hapët. Por vetëvetiu kuptohet se, me zhdukjen e marrëdhënieve të sotme në prodhim, do të zhduket

edhe bashkësia e grave, që është një rrjedhim i këtyre marrëdhënieve, d.m.th. do të zhduket prostitucioni zyrtar dhe jozyrtar.

Pastaj, komunistët qortohen se gjoja duan të zhdukin atdheun, kombësinë.

Punëtorët s'kanë atdhe. Nuk mund t'u heqësh atyre një gjë që nuk e kanë. Por meqenëse proletariati duhet, para së gjithash, të vendosë sundimin politik, të ngrihet në shkallën e një klase kombëtare*, të formohet si komb, ai vetë është ende kombëtar, ndonëse aspak ashtu si e kupton atë borgjezia.

Veçimi kombëtar dhe antagonizmat midis popujve vijnë duke u zhdukur gjithnjë më tepër me zhvillimin e borgjezisë, të tregëtisë së lirë, të tregut botëror, me uniformitetin e prodhimit industrial dhe të kushteve përkatëse të jetesës.

Sundimi i proletariatit do ta shpejtojë edhe më tepër zhdukjen e tyre. Veprimi i bashkuar, të paktën, i vendeve të qytetëruara, është një nga kushtet kryesore për çlirimin e proletariatit.

Në atë masë që do të zhduket shfrytëzimi i një individi nga një tjetër, do të zhduket edhe shfrytëzimi i një kombi nga një tjetër.

Së bashku me antagonizmin e klasave brenda kombeve, do të zhduken edhe marrëdhëniet armiqësore të kombeve midis tyre.

Akuzat që i bëhen komunizmit, duke u nisur nga pikëpamje fetare, filozofike dhe në përgjithësi nga pikëpamje ideologjike, nuk meritojnë të shqyrtohen imtësisht.

A duhet, vallë, ndonjë zgjuarësi e veçantë për të kuptuar se së bashku me kushtet e jetesës së njerëzve, me marrëdhëniet e tyre shoqërore, me qenien e tyre shoqërore, ndryshojnë edhe parafytyrimet, pikëpamjet dhe nocionet, — me një fjalë, ndërgjegjja e tyre?

Po ç'na provon historia e ideve përveç asaj që prodhimi shpirtëror pëson ndryshime së bashku me prodhimin material? Idetë sunduese të çdo kohe kanë qenë gjithnjë vetëm idetë e klasës sunduese.

Flasin për ide që revolucionojnë gjithë shoqërinë. Me këtë

* Në botimin anglisht të vitit 1888 në vend të fjalëve: «të ngrihet në shkallën e një klase kombëtare» është shkruar: «të ngrihet në shkallën e klasës drejtuese të kombit». Red.

shprehin vetëm faktin se brenda shoqërisë së vjetër janë formuar elementet e shoqërisë së re, se krahas me dekompozimin e kushteve të vjetra të jetesës dekompozohen edhe idetë e vjetra.

Kur bota e vjetër po perëndonte, fetë e vjetra u mundën nga feja kristiane. Kur idetë kristiane në shekullin XVIII u përmbysën nga idetë iluministe, shoqëria feudale hyri në një luftë për vdekje kundër borgjezisë, e cila në atë kohë ishte revolucionare. Idetë e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë nuk shprehin gjë tjetër në fushën e dijes veçse sundimin e konkurrencës së lirë.

«Por», mund të na thonë, «idetë fetare, morale, filozofike, politike, juridike etj., sigurisht, kanë ndryshuar gjatë zhvillimit historik. Kurse feja, morali, filozofia, politika dhe e drejta janë ruajtur gjithnjë gjatë këtyre ndryshimeve të parrështura.

Ka pastaj disa të vërteta të përjetshme, si liria, drejtësia etj., që janë të përbashkëta për të gjitha fazat e zhvillimit shoqëror. Mirëpo, komunizmi i zhduk të vërtetat e përjetshme, ai zhduk fenë, moralin, në vend që t'i përtërijë ato; pra, ai është në kundërshtim me gjithë zhvillimin historik të mëparshëm».

Ç'është kjo akuzë? Historia e të gjitha shoqërive që kanë ekzistuar deri më sot, është zhvilluar duke kaluar përmes antagonizmave të klasave, antagonizma që në epokat e ndryshme kanë marrë forma të ndryshme.

Por çfarëdo formash që të kenë marrë këta antagonizma, shfrytëzimi i një pjese të shoqërisë nga një tjetër është një fakt i përbashkët për të gjithë shekujt e kaluar. Prandaj s'është për t'u çuditur, në qoftë se ndërgjegjja shoqërore e të gjithë shekujve, me gjithë këto lloje të shumta dhe këto ndryshime, zhvillohet në disa forma të përbashkëta, në format e ndërgjegjes, të cilat do të zhduken plotësisht vetëm kur të zhduket përgjithmonë antagonizmi i klasave.

Revolucion komunist do të thotë të përmbysen në mënyrën më të vendosur marrëdhëniet e pronësisë, të trashëguara nga e kaluara: s'është për t'u çuditur, në qoftë se gjatë zhvillimit të tij ai shkëputet në mënyrën më të vendosur nga idetë e së kaluarës.

Por le t'i lëmë vërejtjet që bën borgjezia kundër komunizmit.

Më lart ne pamë se hapi i parë në revolucionin punëtor është shndërrimi i proletariatit në klasë sunduese, vendosja e demokracisë.

Proletariati e përdor sundimin e vet politik për të shkëputur nga duart e borgjezisë pak nga pak gjithë kapitalin, për të centralizuar të gjitha veglat e prodhimit në duart e shtetit, d.m.th. të proletariatit të organizuar si klasë sunduese dhe për t'i shtuar sa më shpejt forcat prodhuese.

Sigurisht, kjo mund të bëhet në fillim vetëm me anën e një ndërhyrjeje despotike në të drejtën e pronësisë dhe në marrëdhëniet borgjeze të prodhimit, d.m.th. me anën e masave që ekonomikisht duken si të pamjaftueshme dhe të pathemelta, por që në lëvizje e sipër marrin një zhvillim shumë të madh* dhe janë të pashmangshme si një mjet për të përmbytur gjithë mënyrën e prodhimit.

Këto masa do të jenë, sigurisht, të ndryshme në vende të ndryshme.

Megjithatë në vendet më të përparuara mund të zbatohen pothuajse kudo masat që vijojnë:

1. Shpronësimi i pronës së tokës dhe përdorimi i rentës së tokës për mbulimin e shpenzimeve shtetërore.
2. Tatimi i lartë progresiv.
3. Heqja e së drejtës së trashëgimit.
4. Konfiskimi i pasurisë së të gjithë emigrantëve dhe rebelëve.
5. Centralizimi i kreditit në duart e shtetit nëpërmjet një banke kombëtare me kapital shtetëror dhe me monopol të plotë.
6. Centralizimi i të gjitha mjeteve të transportit në duart e shtetit.
7. Shtimi i numrit të fabrikave shtetërore, të veglave të prodhimit, përvetësimi i tokave djerr dhe përmirësimi i tyre sipas një plani të përgjithshëm.
8. Detyrimi i barabartë për të gjithë që të punojnë, krijimi i ushtrive industriale, sidomos për bujqësinë.

* Në botimin anglisht të vitit 1888 pas fjalëve: «marrin një zhvillim shumë të madh» është shtuar: «i bëjnë të domosdoshme sulmet e mëtejshme kundër rendit të vjetër shoqëror». *Red.*

9. Kombinimi i bujqësisë me industrinë, masat për të zhdukur gradualisht dallimin midis qytetit dhe fshatit*.

10. Edukimi publik dhe falas për të gjithë fëmijët. Ndalimi i punës së fëmijëve në fabrika në formën e sotme. Kombinimi i edukimit me prodhimin material etj.

Kur gjatë zhvillimit ndryshimet e klasave do të zhduken dhe gjithë prodhimi do të përqëndrohet në duart e shoqatës së individëve, atëherë pushteti publik do ta humbasë karakterin e vet politik. Pushteti politik, në kuptimin e vërtetë të fjalës, është dhuna e organizuar e një klase për të shtypur një klasë tjetër. Në qoftë se proletariati në luftën kundër borgjezisë formohet medoemos si klasë, në qoftë se me anë të revolucionit ai bëhet klasë sunduese dhe si klasë sunduese përmbyset me forcë marrëdhëniet e vjetra të prodhimit, së bashku me këto marrëdhënie prodhimi ai zhduk edhe kushtet e ekzistencës së antagonizmit të klasave, zhduk klasat në përgjithësi dhe në këtë mënyrë edhe sundimin e vet si klasë.

Vendin e shoqërisë së vjetër borgjeze me klasat e saj dhe me antagonizmat midis klasave e zë një shoqatë, ku zhvillimi i lirë i secilit është kusht për zhvillimin e lirë të të gjithëve.

* Në botimin e vitit 1848 është: «kontrastin midis qytetit dhe fshatit». Në botimet e mëvonshme gjermanisht, duke filluar prej botimit të vitit 1872, fjala «kontrastin» është zëvendësuar me fjalën «dallimin». Në botimin anglisht të vitit 1888 në vend të fjalëve: «masat për të zhdukur gradualisht dallimin midis qytetit dhe fshatit» është shkruar: «zhdukja graduale e dallimit midis qytetit dhe fshatit me anë të një shpërndarjeje më të barabartë të popullsisë në të gjithë vendin». *Red.*

III

LETËRSIA SOCIALISTE DHE KOMUNISTE

1. SOCIALIZMI REAKSIONAR

a) SOCIALIZMI FEUDAL

Nga shkaku i pozitës së saj historike, aristokracisë franceze dhe angleze i ra barra të shkruante pamflete kundër shoqërisë së sotme borgjeze. Në revolucionin francez të korrikut 1830 dhe në lëvizjen angleze për reformën parlamentare, borgjezia e urryer i dha asaj edhe një grusht tjetër. As që mund të bëhej fjalë më për një luftë politike serioze. Aristokracisë i mbetej vetëm lufta me anën e penës. Por edhe në fushën e letërsisë nuk mund të përdoreshin më frazat e vjetra të kohës së Restaurimit*. Për të fituar simpatinë, aristokracia duhej të bënte sikur nuk kujdesej për interesat e veta dhe sikur donte të formulonte aktakuzën e vet kundër borgjezisë vetëm në interes të klasës punëtore të shfrytëzuar. Ajo kënaqej duke i thurur këngë fyese sundimtarit të vet të ri dhe duke i pëshpëritur atij në vesh profeci pak a shumë të kobshme.

Kështu lindi socializmi feudal: gjysmë vajtim — gjysmë shpifje, gjysmë jehonë e së kaluarës — gjysmë kërcënim i së ardhmes, socializëm që ngandonjëherë e godet borgjezinë mu në zemër me kritikën e tij të hidhur, të mprehtë dhe egërsisht tallëse, por që bëhet gjithnjë qesharak ngaqë nuk është aspak i aftë të kuptojë rrugën që ndjek sot historia.

* Është fjala jo për Restaurimin anglez të vjetëve 1660-1689, por për Restaurimin francez të vjetëve 1814-1830. (Shënim i Engelsit për ootimin anglisht të vitit 1888.)

Për ta bërë popullin me vete, aristokracia mbante lart si flamur trastën prej lypësi të proletariatit. Por sa herë që populli i shkoi pas, ai pa të vulosura në vithet e saj stemat e vjetra feudale dhe u largua duke ia plasur gazit me tallje.

Këtë komedi e lojtën një pjesë e legjitimistëve francezë dhe «Anglia e Re».⁸

Kur feudalët kërkojnë të provojnë se mënyra e tyre e shfrytëzimit ishte e ndryshme nga ajo e shfrytëzimit borgjez, harrojnë se ata shfrytëzonin në kushte dhe në rrethana krejt të ndryshme, të cilave sot u ka kaluar koha. Kur ata thonë se nën sundimin e tyre nuk ekzistonte proletariati i sotëm, harrojnë se pikërisht borgjezia e sotme që fryti i domoshëm i rendit të tyre shoqëror.

Ndërkaq, këta njerëz e fshehin aq pak karakterin reaksionar të kritikës së tyre, saqë akuza e tyre kryesore kundër borgjezisë qëndron pikërisht në faktin se nën sundimin e kësaj zhvillohet një klasë, e cila do ta hedhë në erë gjithë rendin e vjetër shoqëror.

Ata nuk e qortojnë aq shumë borgjezinë sepse lind proletariatin në përgjithësi, ata e qortojnë atë shumë më tepër sepse lind një proletariat revolucionar.

Prandaj në praktikën politike ata marrin pjesë në të gjitha masat e dhunës kundër klasës punëtore, kurse në jetën e përditshme, në kundërshtim me të gjitha frazat e tyre të bujshme, nuk lënë rast pa shfrytëzuar për të mbledhur mollët e arta* dhe për të bërë matrapazllëk, duke shkëmbyer besnikërinë, dashurinë dhe nderin me fitimet që sjell tregëtia e leshit të dhenve, e panxharsheqerit dhe e rakisë**.

Ashtu sikurse prifti ecte kurdoherë krah për krah me feudal, socializmi klerikal ecën krah për krah me socializmin feudal.

* Në botimin anglisht të vitit 1888 pas fjalëve: «mollët e arta» është shtuar: «që bien nga pema e industrisë». Red.

** Kjo i referohet kryesisht Gjermanisë, ku aristokracia agrare dhe junkerët e shfrytëzojnë pjesën më të madhe të tokave të tyre për hesapin e vet, me anën e administratorëve të tyre, dhe njëkohësisht janë pronarë të mëdhenj fabrikash sheqeri dhe distilerish alkooli. Aristokratët më të pasur anglezë ende nuk kanë arritur deri këtu; por edhe ata e dinë se si mund të vihej në vend rënia e rentës, duke ua huajtur emrin e vet themeluesve pak a shumë të dyshimtë të shoqërive aksionare. (Shënim i Engelsit për botimin anglisht të vitit 1888.)

S'ka gjë më të lehtë se t'i japësh një ngjyrë socialiste asketizmit kristian. A nuk ka luftuar edhe kristianizmi kundër pronës private, kundër martesës, kundër shtetit? Dhe në vend të këtyre, a nuk ka predikuar ai se duhet të jesh mirëbërës dhe lypës, se duhet të mos martohesh dhe të mortnosh trupin, se duhet të bësh jetën e murgjëve dhe të vesh në kishë? Socializmi kristian s'është gjë tjetër veçse uji i bekuar, me të cilin prifti spërkat mërinë e aristokratëve.

b) SOCIALIZMI MIKROBORGJEZ

Aristokracia feudale nuk është klasa e vetme, e përmbysur nga borgjezia, dhe as e vetmja klasë, së cilës i janë keqësuar dhe zhdukur kushtet e jetesës në shoqërinë e sotme borgjeze. Shtresa e qytetarëve të mesjetës dhe shtresa e fshatarëve të vegjël kanë qenë paraardhësit e borgjezisë së sotme. Në vendet më pak të zhvilluara nga pikëpamja industriale dhe tregëtare kjo klasë vegjeton ende pranë borgjezisë që po zhvillohet.

Në vendet ku është zhvilluar qytetërimi modern, është formuar një borgjezi e vogël e re, e cila lëkundet në mes të proletariatit e borgjezisë dhe, si pjesë plotësuese e shoqërisë borgjeze, përtërihet vazhdimisht. Por konkurrenca i hedh vazhdimisht në radhët e proletariatit pjesëtarët e kësaj klase. dhe këta fillojnë të shohin afrimin e çastit kur, me zhvillimin e industrisë së madhe, do të zhduken krejt si pjesë e pavarur e shoqërisë së sotme dhe kur në tregëti, në industri dhe në bujqësi do të zëvendësohen nga mbikëqyrës dhe nga nëpunës rrogetarë.

Në vende të tilla si Franca, ku fshatarësia përbën shumë më tepër se gjysmën e popullsisë, ishte e natyrshme të delnin shkrimtarë, të cilët, duke marrë anën e proletariatit kundër borgjezisë, në kritikën e tyre të rendit borgjez t'i peshonin punët me kandarin e borgjezit të vogël dhe të fshatarit të vogël dhe ta mbronin çështjen e punëtorëve nga pozita mikroborgjeze. Kështu lindi socializmi mikroborgjez. Sismondi qëndron në krye të kësaj letërsie jo vetëm në Francë, por edhe në Angli.

Ky socializëm diti t'i kapte shumë mirë kontradiktat në marrëdhëniet e sotme të prodhimit. Ai e demaskoi apologjinë hipokrite të ekonomistëve. Ai provoi në mënyrë të pakundër-

shtueshme se prodhimi me anën e maqinave dhe ndarja e punës do të kenë pasoja shkatërrimtare, se kapitalet dhe prona e tokës do të koncentrohen, se do të ketë superprodhim dhe kriza, se borgjezët e vegjël dhe fshatarët e vegjël do të zhduken patjetër, se proletariati do të varfërohet, se do të ketë anarki në prodhim dhe një pabarazi të tmerrshme në ndarjen e pasurisë, se do të bëhen luftëra industriale shfarosëse midis kombeve, do të zhduken zakonet e vjetra, marrëdhëniet e vjetra familjare dhe kombësitë e vjetra.

Po ta shikojmë nga përmbajtja e tij e vërtetë, ky socializëm don ose të rivendosë mjetet e vjetra të prodhimit dhe të këmbimit dhe, së bashku me to, marrëdhëniet e vjetra të pronësisë dhe shoqërinë e vjetër, ose — t'i ndryjë përsëri përdhunisht mjetet e sotme të prodhimit dhe të këmbimit në kuadrin e marrëdhënieve të vjetra të pronësisë, marrëdhënie që janë hedhur në erë tashmë prej tyre dhe duheshin hedhur në erë. Në të dy këto raste ai është njëkohësisht edhe reaksionar edhe utopik.

Organizimi i industrisë në esnafe dhe bujqësia patriarkale — ja fjala e tij e fundit.

Në zhvillimin e vet të mëtejshëm kjo rrymë u degjenerua në vajtime burracakësh*.

c) SOCIALIZMI GJERMAN OSE SOCIALIZMI «I VËRTETË»

Letërsia socialiste dhe komuniste e Francës, që lindi nën shtypjen e borgjezisë sunduese dhe që është shprehja letrare e luftës kundër këtij sundimi, u importua në Gjermani në një kohë kur borgjezia porsa kishte filluar atje luftën e vet kundër absolutizmit feudal.

Filozofët, gjysmëfilozofët dhe amatorët gjermanë të frazave të bukura e përfaquan me etje këtë letërsi, por harruan se me importimin e këtyre shkrimeve nga Franca në Gjermani atje nuk u importuan njëkohësisht edhe kushtet e jetesës që ekzistonin në Francë. Në kushtet gjermane letërsia franceze

* Në botimin anglisht të vitit 1888 në vend të fjalëve: «Në zhvillimin e vet të mëtejshëm kjo rrymë u degjenerua në vajtime burracakësh» është shkruar: «Në fund të fundit, kur faktet historike të pakundërshueshme i zhdukën të gjitha gjurmat e veprimit dehës të iluzioneve, kjo formë e socializmit u degjenerua në vajtime të ulëta». Red.

humbi çdo kuptim praktik imediat dhe mori pamjen e një rryme thjesht letrare. Ajo duhej të merrte karakterin e filozofimeve të kota mbi realizimin e natyrës njerëzore. Kështu, kërkesat e revolucionit të parë francez për filozofët gjermanë të shekullit XVIII kishin kuptim vetëm si kërkesa të «arësyes praktike» në përgjithësi, kurse shfaqjet e vullnetit të borgjezisë revolucionare franceze në sytë e tyre kishin marrë kuptimin e ligjeve të vullnetit të kulluar, të vullnetit ashtu si duhet të jetë, të vullnetit me të vërtetë njerëzor.

Gjithë puna e letrarëve gjermanë ishte vetëm e vetëm që të pajtonin idetë e reja franceze me ndërgjegjen e tyre të vjetër filozofike, ose, më mirë të themi, që të përvetësonin idetë franceze nga pikëpamja e vet filozofike.

Ky përvetësim u bë në po atë mënyrë, siç përvetësohet në përgjithësi një gjuhë e huaj, me anën e përkthimit.

Dihet se sipër tekstit të dorëshkrimeve klasike të botës së vjetër pagane murgjit jepnin jetëshkrimet absurde të shenjtorëve katolikë. Në drejtim të kundërt vepruan letrarët gjermanë me letërsinë profane franceze. Nën origjinalin francez ata shkruan marrëzitë e tyre filozofike. Për shembull, nën kritikën franceze të marrëdhënieve monetare ata shkruan «jetërsimi i natyrës njerëzore», nën kritikën franceze të shtetit borgjez — «zhdukja e sundimit të Universales Abstrakte» etj.

Vënia e frazeologjisë së tyre filozofike në teoritë franceze u pagëzua prej tyre «filozofi e veprimit», «socializëm i vërtetë», «shkencë gjermane e socializmit», «argumentim filozofik i socializmit» etj.

Kështu letërsisë franceze socialiste-komuniste iu hoq krejt përmbajtja. Dhe, meqenëse në duart e gjermanëve ajo pushoi së shprehuri luftën e një klase kundër një tjetre, gjermani u bind se ai kishte dalë përmbi «njëanësinë franceze», se ai në vend të nevojave të vërteta mbronte nevojën për të vërtetën dhe në vend të interesave të proletariatit — interesat e natyrës njerëzore, interesat e njeriut në përgjithësi, të njeriut që nuk bën pjesë në asnjë klasë dhe që përgjithësisht ekziston jo në realitetin, por në qiellin mjegullor të fantazisë filozofike.

Ky socializëm gjerman, që i konsideronte aq serioze dhe të rëndësishme ushtrimet e tij trashanike skolastike dhe që i reklamonte ato me aq bujë, e humbi pak nga pak naivitetin e vet pedant.

Lufta e borgjezisë gjermane, sidomos e borgjezisë prusia-

ne, kundër feudalëve dhe monarkisë absolute — me një fjalë, lëvizja liberale — po bëhej gjithnjë më serioze.

Socializmit «të vërtetë» iu dha kështu rasti i dëshiruar që përballë lëvizjes politike të vinte kërkesat socialiste, t'u jepte mallëkimin tradicional liberalizmit, shtetit me organe përfaqësuese, konkurrencës borgjeze, lirisë borgjeze të shtypit, së drejtës borgjeze, lirisë borgjeze dhe barazisë dhe t'i predikonte masës së popullit se në këtë lëvizje borgjeze ajo nuk mund të fitojë asgjë, por, përkundrazi, rrezikon të humbasë gjithshka. Socializmi gjerman me shumë të drejtë harroi se kritika franceze, jehonë e zbetë e së cilës ai ishte, nënkuptonte shoqërinë e sotme borgjeze me kushtet përkatëse materiale të jetesës dhe me kushtetutën politike përkatëse, d.m.th. pikërisht të gjitha ato premisa që në Gjermani mbeteshin ende për t'u fituar.

Qeverive absolutiste gjermane, me suitën e tyre të priftërinjve, dhaskenjve, junkerëve dhe burokratëve prapanikë, ky socializëm u shërbeu si një gogol i dobishëm kundër borgjezisë që po ngrihej plot kërcënim.

Ai që një plotësim i ëmbël për hidhërimin e kamxhikut dhe të plumbave, me të cilët këto qeveri shtypnin kryengritjet e punëtorëve gjermanë.

Në qoftë se socializmi «i vërtetë» u bë në këtë mënyrë një armë në duart e qeverive kundër borgjezisë gjermane, ai shërbeu edhe drejt për së drejti si shprehje e interesave reaksionare, e interesave të borgjezisë së vogël gjermane. Në Gjermani bazën e vërtetë shoqërore të rendit ekzistues e përbën borgjezia e vogël, e trashëguar qysh prej shekullit XVI dhe e cila që prej asaj kohe e këtej shfaqet vazhdimisht në një formë ose në një tjetër.

Ta ruash atë është njësoj si të ruash rendin që ekziston sot në Gjermani. Nga sundimi industrial dhe politik i borgjezisë borgjezia e vogël pret me frikë vdekjen e vet të sigurt, nga njëra anë, për shkak të koncentrimin të kapitalit, nga ana tjetër — për shkak të rritjes së proletariatit revolucionar. Asaj i dukej se socializmi «i vërtetë» do të vriste me një gur dy zogj. Dhe socializmi «i vërtetë» u përhap si një epidemi.

Pezhishka e endur me fije spekulative, e qindisur me lule të bukura elokuence, e njomur me lot sentimentalizmi, kjo vëllë mistike, me të cilën socialistët gjermanë mbulonin ato dytri «të vërteta të përjetshme», të mbetura kockë e lëkurë, s'bëri gjë tjetër veçse shtoi shitjen e mallit të tyre në këtë publik.

Nga ana e vet, socializmi gjerman e kuptonte gjithnjë më tepër se misioni i tij ishte të bëhej përfaqësuesi i bujshëm i kësaj borgjezie të vogël.

Ai e shpalli kombin gjerman si komb model, kurse borgjezin e vogël gjerman — si njeri model. Çdo poshtërsie të tij ai i dha një kuptim misterioz, të lartë, socialist, që e shndërronte këtë në diçka krejt të kundërt me atë që ishte në realitet. Konsekuent deri në fund, ai u shpreh haptazi kundër tendencës «brutale dhe shkatërruese» të komunizmit dhe deklaroi se me paanësinë e tij madhështore ai qëndronte përmbi çdo luftë klase. Përveç disa përjashtimeve të vogla, të gjitha shkrimet që qarkullojnë në Gjermani, si shkrime gjoja socialiste dhe komuniste, i përkasin kësaj letërsie të ndyrë dhe korruptuese*.

2. SOCIALIZMI KONSERVATOR OSE BORGJEZ

Një pjesë e borgjezisë dëshiron t'i shërojë plagët shoqërore për të konsoliduar kështu ekzistencën e shoqërisë borgjeze.

Këtu hyjnë ekonomistë, filantropë, kampionë të humanizmit, ata që kujdesen për të mirën e klasave punonjëse, organizatorë të bamirësisë, anëtarë të shoqërive për mbrojtjen e kafshëve, themelues të shoqërive kundër alkoolizmit dhe llojlloj reformatorësh të vegjël. Ky socializëm borgjez u zhvillua bile në sisteme të tëra.

Si shembull po sjellim «Filozofinë e mjerimit» të Prudonit.

Borgjezët socialistë duan t'i ruajnë kushtet e ekzistencës së shoqërisë së sotme, por pa luftën dhe rreziket që rrjedhin prej tyre në mënyrë të pashmangshme. Ata duan ta ruajnë shoqërinë e sotme, por pa ato elemente që e revolucionojnë dhe e shthurin atë. Ata do të donin të kishin një borgjezi pa proletariat. Bota në të cilën sundon borgjezia, sigurisht, asaj i duket si më e mira nga të gjitha të tjerat. Këtë parafytyrim ngushullues socializmi borgjez e shndërron në një sistem pak a shumë të plotë. Duke e ftuar proletariatin të realizojë sistemin

* Stuhia revolucionare e vitit 1848⁹ e fshiu gjithë këtë rrymë të fëlliur dhe u hoqi bartësve të saj çdo dëshirë për të spekuluar me socializmin. Përfaqësuesi kryesor dhe tipi klasik i kësaj rryme është z. Karl Gryn. (Shënim i Engelsit për botimin gjermanisht të vitit 1890.)

e tij dhe të hyjë në Jeruzalemin e ri, ky socializëm s'bën tjetër veçse kërkon që proletariati të mbetet në shoqërinë e sotme, por me kusht që të flakë idenë që ka për këtë shoqëri si për diçka të urryer.

Një tjetër formë e këtij socializmi, më pak sistematike, por më praktike, është përpjekur që klasën punëtore ta largojë nga çdo lëvizje revolucionare, duke i provuar se ajo që mund t'i vlejë kësaj nuk është ky ose ai transformim politik, por vetëm ndryshimi i kushteve materiale të jetesës, ndryshimi i marrëdhënieve ekonomike. Megjithatë, ky socializëm për ndryshim të kushteve materiale të jetesës nuk kupton aspak zhdukjen e marrëdhënieve borgjeze në prodhim, gjë që mund të realizohet vetëm me rrugë revolucionare, por përmirësime administrative që mund të realizohen mbi bazën e këtyre marrëdhënieve në prodhim, pra, që nuk ndryshojnë asgjë në marrëdhëniet midis kapitalit dhe punës me mëditje, dhe që në rastin më të mirë s'bëjnë tjetër veçse i pakësojnë shpenzimet që bën borgjezia për të sunduar dhe thjeshtojnë administrimin e saj shtetëror.

Ky socializëm borgjez e gjen shprehjen e vet më të përshtatshme vetëm atëherë kur bëhet një figurë e thjeshtë retorike.

Tregëti e lirë! në interes të klasës punëtore; tarifa doganore mbrojtëse! në interes të klasës punëtore; biruca! në interes të klasës punëtore — ja fjala e fundit e socializmit borgjez, e vetmja fjalë e thënë prej tij seriozisht.

Socializmi i borgjezisë qëndron pikërisht në pohimin se borgjezët janë borgjezë, — në interes të klasës punëtore.

3. SOCIALIZMI DHE KOMUNIZMI KRITIK-UTOPIK

Këtu ne nuk flasim për atë letërsi, e cila në të gjitha revolucionet e mëdha të kohës së re ka shprehur kërkesat e proletariatit (shkrimet e Babëfit etj.).

Orvatjet e para të proletariatit për të realizuar menjëherë interesat e tij të klasës në kohën kur gjithshka zien, në periudhën e përmbyssjes së shoqërisë feudale, kanë dështuar që të gjitha, sepse vetë proletariati nuk ishte i zhvilluar dhe sepse mungonin kushtet materiale për çlirimin e tij, pasi këto kushte janë vetëm produkt i epokës borgjeze. Letërsia revolucionare,

që i shoqëroi këto lëvizje të para të proletariatit, nga përmbajtja e saj është patjetër letërsi reaksionare. Ajo predikon një asketizëm universal dhe një tendencë trashanike për të barazuar çdo gjë.

Sistemet me të vërtetë socialiste dhe komuniste, sistemet e Sen-Simonit, të Furjesë, të Ouenit etj., lindin në periudhën e parë, për të cilën kemi folur më lart, në periudhën kur lufta midis proletariatit dhe borgjezisë nuk ka marrë ende zhvillimin e duhur (shih «Borgjezia dhe proletariati»).

Është e vërtetë se shpikësit e këtyre sistemeve e shohin antagonizmin midis klasave, po ashtu si dhe veprimin e elementeve shkatërruese në gjirin e vetë shoqërisë sunduese, por ata nuk shohin te proletariati asnjë veprimtari historike, asnjë lëvizje politike të vetën.

Meqenëse antagonizmi i klasave zhvillohet krah për krah me zhvillimin e industrisë, shpikësit e këtyre sistemeve s'kanë se si t'i gjejnë kushtet materiale për çlirimin e proletariatit dhe kërkojnë një shkencë të tillë sociale, ligje të tilla sociale, të cilat t'i krijojnë këto kushte.

Vendin e veprimtarisë shoqërore duhet ta zërë veprimtaria e tyre shpikëse personale, vendin e kushteve historike të çlirimit duhet ta zënë kushtet fantastike, vendin e organizimit të proletariatit në klasë, organizim që po shkon përpara gradualisht, duhet ta zërë organizimi i shoqërisë sipas një recete të trilluar prej tyre. Historia e mëtejshme e gjithë botës s'është gjë tjetër për ta veçse propagandimi dhe realizimi në praktikë i planeve të tyre shoqërore.

Është e vërtetë se ata e kuptojnë që me këto plane mbrojnë kryesisht interesat e klasës punëtore, si klasa që vuan më tepër. Dhe proletariati për ta ekziston vetëm si klasë që vuan më tepër.

Por zhvillimi i paktë i luftës së klasave, si dhe gjendja e tyre në jetë bëjnë që këta ta konsiderojnë veten si njerëz që qëndrojnë shumë lart përmbi këtë antagonizëm klasash. Ata duan të përmirësojnë gjendjen e të gjithë anëtarëve të shoqërisë, edhe të atyre që ndodhen në kushtet më të mira. Prandaj ata i bëjnë vazhdimisht thirrje gjithë shoqërisë pa dallim dhe bile më tepër klasës sunduese. Sipas mendimit të tyre, mjafton vetëm të kuptohet sistemi i tyre, për të pranuar se ai është plani më i mirë për shoqërinë më të mirë që mund të bëhet.

Prandaj ata janë kundër çdo veprimi politik, dhe sidomos

kundër çdo veprimi revolucionar; ata duan t'ia arrijnë qëllimit të tyre me rrugë paqësore dhe përqipen t'i hapin rrugën ungjillit të ri shoqëror duke dhënë shembullin dhe duke bërë eksperimente të vogla që, sigurisht, s'kanë sukses.

Ky përshkrim fantastik i shoqërisë së ardhshme lind atëherë kur proletariati ndodhet ende në një gjendje shumë pak të zhvilluar dhe për këtë arsye e përfytyron ende gjendjen e vet në një mënyrë fantastike, ai lind nga impulsi i parë i proletariatit, impuls plot me parandjenja për një transformim të përgjithshëm të shoqërisë.

Por këto shkrime socialiste dhe komuniste përmbajnë edhe elemente kritike. Këto shkrime sulmojnë të gjitha bazat e shoqërisë ekzistuese. Prandaj ato kanë dhënë material shumë të çmueshëm për t'u hapur sytë punëtorëve. Konkluzionet e tyre pozitive në lidhje me shoqërinë e ardhshme, për shembull, zhdukja e kontrastit midis qytetit dhe fshatit*, zhdukja e famijes, e fitimit privat, e punës me mëditje, shpallja e harmonisë shoqërore, shndërrimi i shtetit në një organ të thjeshtë për të administruar prodhimin, — të gjitha këto teza nuk shprehin gjë tjetër veçse nevojën e domosdoshme të zhdukjes së antagonizmit të klasave, i cili porsa kishte filluar të zhvillohej dhe të cilin ato e njihnin vetëm në formën e tij të parë, të papërcaktuar. Prandaj edhe këto teza kanë ende një karakter krejt utopik.

Rëndësia e socializmit dhe e komunizmit kritik-utopik është në raport të zhdrejtë me zhvillimin historik. Sa më tepër zhvillohet lufta e klasave dhe sa më të përcaktuara bëhen format e saj, aq më tepër humb çdo kuptim praktik dhe çdo bazë teorike kjo tendencë fantastike për t'u ngritur mbi luftën e klasave, ky qëndrim fantastik që e mohon luftën e klasave. Prandaj në qoftë se themeluesit e këtyre sistemeve nga shumë pikëpamje kanë qenë revolucionarë, nxënësit e tyre formojnë kurdoherë sekte reaksionare. Ata mbahen fort pas pikëpamjeve të vjetra të mësuesve të tyre, pa marrë parasysh zhvillimin e mëtejshëm historik të proletariatit. Prandaj ata përqipen vazhdimisht për ta zbutur përsëri luftën e klasave dhe për të pajtuar antagonizmat. Ata vazhdojnë ende të ëndërrojnë për të

* Në botimin anglisht të vitit 1888 kjo pjesë është formuluar kështu: «Masat praktike që ata propozojnë, p.sh. zhdukja e dallimit midis qytetit dhe fshatit». Red.

realizuar, me anë eksperimentesh, utopitë e veta shoqërore, për të themeluar disa falansteri, për të formuar koloni të brendshme [«Home-colonies»], për të ndërtuar një Ikari të vogël* — botim xhepi i një Jeruzalemi të ri, — dhe për të ndërtuar të gjitha këto kështjella në erë janë të shtërnguar t'i drejtohen filantropisë së zemrave dhe kuletave të borgjezisë. Ata po bien pak nga pak në kategorinë e socialistëve reaksionarë ose konservatorë, që përshkruam më sipër, dhe dallohen prej tyre vetëm nga një pedantizëm më sistematik dhe nga një besim fanatik në forcën çudibërëse të shkencës së tyre sociale.

Ja përse ata kundërshtojnë me tërbim çdo lëvizje politike të punëtorëve, që, sipas mendimit të tyre, shkaktohet vetëm nga mosbesimi i verbër në ungjillin e ri.

Ouenistët në Angli dhe furjeristët në Francë ngrihen — të parët kundër çartistëve, të dytët kundër reformistëve¹⁰.

* Falansteri quheshin kolonitë socialiste që projektonte Furjé; Kabaja quante Ikari vendin e tij utopik dhe më vonë koloninë e tij komuniste në Amerikë. (*Shënim i Engelsit për botimin anglisht të vitit 1888.*)

Home-colonies (koloni brenda vendit) Oueni quante shoqëritë e tij komuniste model. Falansteri quheshin pallatet publike që projektonte Furjé. Ikari quhej vendi fantastik-utopik, institucionet komuniste të të cilit i përshkroi Kabaja. (*Shënim i Engelsit për botimin gjermanisht të vitit 1890.*)

IV

QËNDRIMI I KOMUNISTËVE KUNDREJT PARTIVE TË NDRYSHME OPOZITARE

Nga sa u tha në kapitullin II kuptohet cili është qëndrimi që mbajnë komunistët kundrejt partive punëtore tashmë të formuara, d.m.th. qëndrimi i tyre kundrejt çartistëve në Angli dhe kundrejt partizanëve të reformës agrare në Amerikën Veriore.

Komunistët luftojnë në emër të qëllimeve dhe të interesave imediate të klasës punëtore, por në të njëjtën kohë në lëvizjen e sotme ata mbrojnë edhe të ardhmen e lëvizjes. Në Francë, në luftën kundër borgjezisë konservatore dhe radikale, komunistët bashkohen me partinë socialiste-demokrate*, por pa hequr dorë nga e drejta për t'i parë me sy kritik frazat dhe iluzionet që rrjedhin nga tradita revolucionare.

Në Zvicër ata përkrahin radikalët, por duke pasur gjithnjë parasysh se kjo parti përbëhet prej elementësh kontradiktorë, pjesërisht prej socialistësh demokratë të stilit francez, pjesërisht prej borgjezësh radikalë.

Në Poloni komunistët përkrahin partinë që vë revolucionin agrar si një kusht për çlirimin nacional, atë parti që shkaktoi kryengritjen e Krakovisë të vitit 1846.

Në Gjermani, meqenëse borgjezia mban një qëndrim revolucionar, partia komuniste lufton bashkë me të kundër monarkisë absolute, pronës feudale të tokës dhe borgjezisë së vogël reaksionare.

* Kjo parti përfaqësohej në atë kohë në parlament nga Lëdry-Roleni, në letërsi — nga Lui Blani, në shtypin e përditshëm — nga gazeta «La Réforme». Me emrin — socialiste-demokrate — quanin atë pjesë të partisë demokrate ose republikane që paraqitej ku më shumë e ku më pak me ngjyrë socialiste. (*Shënim i Engelsit për botimin anglisht të vitit 1888.*)

Partia e vetëquajtur socialiste-demokrate në Francë përfaqësohej në jetën politike nga Lëdry-Roleni, në letërsi — nga Lui Blani; kështu ajo ndryshonte si qielli prej tokës nga socialdemokracia e sotme gjermane. (*Shënim i Engelsit për botimin gjermanisht të vitit 1890.*)

Por ajo për asnjë çast nuk e pushon punën e vet për t'i bërë punëtorët ta kuptojnë sa më qartë kontrastin armiqësor midis borgjezisë dhe proletariatit, në mënyrë që punëtorët gjermanë të jenë në gjendje t'i shfrytëzojnë menjëherë kushtet shoqërore dhe politike që duhet të sjellë me vete sundimi i borgjezisë, si një armë kundër vetë asaj, në mënyrë që menjëherë pas përmbysjes së klasave reaksionare në Gjermani të fillojë lufta kundër vetë borgjezisë.

Komunistët vëmendjen e vet kryesore e kanë përqëndruar te Gjermania, sepse ajo ndodhet në prakun e revolucionit borgjez, sepse ajo do ta bëjë këtë revolucion në kushte më të përparuara të qytetërimit evropian në përgjithësi, me një proletariat shumë më të zhvilluar se në Anglinë e shekullit XVII dhe në Francën e shekullit XVIII. Pra, revolucioni borgjez gjerman s'mund të jetë veçse prologu imediat i revolucionit proletar.

Me një fjalë, komunistët përkrahin kudo çdo lëvizje revolucionare që drejtohet kundër rendit shoqëror dhe politik ekzistues.

Në të gjitha këto lëvizje ata nxjerrin në plan të parë çështjen e pronës, si çështjen kryesore të lëvizjes, pavarësisht nëse kjo çështje ka marrë apo jo një formë pak a shumë të zhvilluar.

Më në fund, komunistët përpiqen kudo që të arrijnë një bashkim dhe një marrëveshje midis partive demokratike të të gjitha vendeve.

Komunistët e quajnë një gjë të shëmtuar të fshehin pikëpamjet dhe qëllimet e veta. Ata deklarojnë haptazi se qëllimet e tyre mund të arrihen vetëm duke përmbysur me forcë gjithë rendin shoqëror ekzistues. Le të dridhen klasat sunduese përpara Revolucionit Komunist. Proletarët s'kanë ç'të humbasin në të veç prangave të tyre. Ata kanë për të fituar gjithë botën.

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

*Shkruar nga K. Marksi dhe
F. Engelsi në dhjetor 1847*

— janar 1848

*Botuar për herë të parë
si broshurë e veçantë në
shkurt të vitit 1848 në*

Londër

*Botohet sipas Veprave të K. Marksit
e të F. Engelsit, bot. i 2-të rus.,
vëll. 4, f. 419-459*